

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5699
E hënë, 11 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Në 12-vjetorin e vrasjes, kërkohet drejtësi për Arbenin dhe Monin



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

'KRIZA NË KOSOVË, ZGJIDHJA ENDE E LARGËT'



Nga Jakup KRASNIQI

12 VJET NGA 10 SHKURTI



Shkruan: Albin KURTI

PUNËTORËT E SHËRBIMIT KORREKTUES SOT PROTESTOJNË KUNDËR LIGJIT TË PAGAVE

F.3

EKONOMI

AUTOSTRADA PRISHTINË - HAN I ELEZIT PËRFUNDON NË QERSHOR

F.9

AKADEMIKU SHQIPTAR: PASURITË E 'TREPÇËS' KAPIN VLERËN PREJ 500 MILIARDË DOLLARËSH

F.9

KULTURË

LIGJI, PARAARDHËSIT DHE PASARDHËSIT

F.13

Flamur MALOKU

NJË DOKUMENT I RËNDËSISHËM PËR LIKUIDIMIN E MULLA IDRIZ GJILANIT

F.13

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

SPORT

KUPA SJELL BEFASI, ELIMINOHEN PRISHTINA DHE DRITA

F.18

FLET PËR 'EPOKËN E RE', BURIM RAMADANI

KOSOVA DO TË JETË ANËTARJA E 31-të E NATO-S



Zëvendësministri i Mbrojtjes, Burim Ramadani, është shprehur i bindur se Republika e Kosovës do të jetë anëtarja e 31-të e NATO-s. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se për këtë synim Kosova duhet t'i thellojë përpjekjet politike dhe diplomatike. Ramadani ka mohuar çdo

mundësi që moslargimi i taksës për mallrat serbe të ndikojë në raportet e FSK-së me ShBA-në. Sipas zëvendësministrit të Mbrojtjes, këto dy gjëra nuk janë të lidhura mes vete. "Partneriteti strategjik special me ShBA-në nuk është ad hoc, por i qëndrueshëm dhe i përgjithmonshëm", ka thënë

Ramadani. Në këtë intervistë dhënë me rastin e shënimit të 11-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, Ramadani ka bërë thirrje që tërë skena politike dhe institucionale të reflektojë edhe një herë përkushtimin për të avancuar, mbrojtur dhe garantuar shtetin e Kosovës të shpallur më 17 shkurt 2008

BISEDË ME KRYETARIN E SHOQATËS SË EKSPORTUESVE TË KOSOVËS, NEXHAT HASANI

FAQE 8

Hasani: Taksa ndaj Serbisë dhe Bosnjës të mos hiqet

Kryetari i Shoqatës së Eksportuesve të Kosovës, Nexhat Hasani, ka thënë se nga dita e marrjes së vendimit të Qeverisë së Kosovës për vënien e taksës 100 për qind ndaj mallrave të Serbisë dhe të Bosnjë Hercegovinës, eksportuesit e Kosovës kanë shënuar përparim si në eksport, po ashtu edhe në numrin e të punësuarve. Sipas tij, pos efekteve politike, kjo taksë në masë të madhe ka dhënë efekte ekonomike dhe ka vetëdijësuar edhe konsumatorët



LDK-ja thotë se Ligji për paga u bë për vota

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Hahni: Bisedimet me Maqedoninë mund të fillojnë në qershor të këtij viti

BRUKSEL, 10 SHKURT - Komisionari për zgjerim në Bashkimin Evropian (BE), Johannes Hahn, ka thënë se nëse zbatohen reformat, BE-ja do të pajtohet që bisedimet me Maqedoninë e Veriut të nisnin këtë vit.

Hahni edhe një herë e ka

përshëndetur nënshkrimin e protokollit për NATO dhe zgjidhjen e kontestit me Greqinë si "hap që vendos integritimin euroatlantik" të, siç e ka quajtur ai, "Republikës së Maqedonisë së ardhshme të Veriut". "Ju duartrokas të gjithë liderëve politikë të përfshirë. Ky është


edhe një vendim historik i arritur nga lidhshipi në vend, integrimi në NATO i Republikës së Maqedonisë së Veriut do të kontribuojë për sigurinë dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor dhe Evropës në përgjithësi", ka thënë Hahni. Edhe pse dy proceset janë të

ndryshme dhe të ndara, me kushte të specifikuar dhe procedura për secilën nga dy organizatat, sipas tij, procesi në NATO dhe BE në mënyrë paralele sjell më shumë stabilitet dhe paqe dhe bazohen në të njëjtat principe si sundimi i së drejtës dhe demokracia.



Qendra sekrete e Rosisë në Nish, kërcënim për sigurinë e Kosovës

Fondacioni "Carnegie" për Paqen Ndërkombëtare nga Uashingtoni ka publikuar një studim në të cilin thuhet se shteti rus mund t'i përdorë sulmet kibernetike për t'i penguar zhvillimet në Ballkan, duke përmendur kështu edhe marrëveshjen finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë



PRISHTINË, 10 SHKURT - Fondacioni "Carnegie" për Paqen Ndërkombëtare që është themeluar në vitin 1910 në Uashington të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka publikuar një studim nëpërmjet të cilit ka paralajmëruar shtetet e Ballkanit Perëndimor, e veçanërisht Kosovën për sulme të mundshme kibernetike që mund të vijnë nga Rusia e Vladimir Putinit. Kjo organizatë e cila ka qendrat e veta në gjashtë vende të ndryshme të botës, ka theksuar se shteti rus mund t'i përdorë sulmet kibernetike për t'i penguar zhvillimet në Ballkan, duke përmendur kështu edhe marrëveshjen finale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Incidentet e ndryshme

kibernetike dëshmojnë se Rusia ka mekanizëm të fuqishëm për sulme kibernetike dhe keqinformim. Para diskutimeve për shkëmbimin e territoreve mes Kosovës dhe Serbisë dhe anëtarësimit të Maqedonisë Veriore në NATO, faktorët e jashtëm mund t'i përdorin sulmet kibernetike për ta penguar zhvillimin e këtyre proceseve", është thënë në hulumtimin e kësaj qendre të cilin e ka siguruar "Gazeta Express". Si pasojë e këtij rreziku, është thënë se shtetet ballkanike janë duke marrë masa dhe po rrisin kapacitetet e tyre mbrojtëse. "Si rezultat i kësaj, disa shtete ballkanike janë duke i shtuar kapacitetet e tyre për mbrojtje ndaj sulmeve

kibernetike në bashkëpunim me shtetet perëndimore. Rusia vlerësohet si njëra ndër kërcënimet më serioze në rajon për sulme kibernetike", është thënë në këtë hulumtim. Sipas kësaj analize, është bërë me dije se shumë shtete dyshojnë se Rusia ka një qendër të fshehtë të inteligjencës në Nish të Serbisë, përmes të cilës monitoron zhvillimet në Kosovë, Serbi dhe Maqedoni. "Shumë shtete perëndimore dyshojnë se qendra ruse për shërbime emergjente në Nish i shërben Rosisë si qendër e inteligjencës. Pavarësisht qëllimit

të vërtetë të ndërtimit të saj, kjo qendër ia ofron Moskës një platformë potenciale për t'i monitoruar zhvillimet në Serbi dhe në shtete tjera, si Bosnjë, Bullgari, Kosovë dhe Maqedoni Veriore", është thënë në hulumtimin e Fondacionit "Carnegie" për Paqen Ndërkombëtare. Ndër të tjera, është bërë me dije edhe strategjia e politikanëve rusë, për nxitjen e tensioneve në Ballkan, përmes deklarimeve të rrejshme. "Në vitin 2015, Lavrovi dhe zyrtarët e tjerë rusë shkuan aq larg, sa që i akuzuan shtetet anëtare të NATO-s, Shqipërinë dhe

Bullgarinë, se po synojnë ta copëtojnë Maqedoninë. Ministri bullgari i Punëve të Jashtme i kishte quajtur të papërgjegjshme këto deklarata. Dy vjet më vonë, Ministria e Jashtme ruse deklaroi se Shqipëria, e ndihmuar nga Bashkimi Evropian, NATO-ja dhe Kosova, ka pretendime territoriale ndaj Greqisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Në të dyja rastet, përmes ndërkombëtarizimit të çështjeve që në fakt ishin çështje të brendshme, zyrtarët rusë nxitën tensione mes maqedonasve dhe shqiptarëve dhe mosmarrëveshje tjera rajonale", është thënë në këtë hulumtim.

Se Rusia nuk është e interesuar që të zgjidhen problemet në Ballkan e kanë thënë edhe shumë analistë e njohës të politikës ndërkombëtare. Këtë gjë sipas tyre e ka dëshmuar edhe vizita e fundit e Putinit në Beograd, pas të cilës presidenti rus nuk deklaroi asgjë që Serbia mund ta konsideronte si përkrahje për zgjidhjen e problemit me Kosovën.

Shqipëria të enjten ratifikon Protokollin për Maqedoninë në NATO



Tiranë, 10 shkurt - Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, ka thënë se të enjten Kuvendi i Shqipërisë pritet ta ratifikojë protokollin për anëtarësim të Maqedonisë në NATO. Në takimim me ambasadorin maqedonas Danço Markovski ai tha se data e parë e mundshme për ratifikim është 14 shkurti kur është planifikuar seanca e Kuvendit, ndërsa qeveria tashmë e ka miratuar

këtë vendim.

Kryetari i Kuvendit përgëzoi për arritjen historike e të shumëpritur, e cila është përshëndetur nga të gjitha institucionet shqiptare dhe që është një lajm i mirë jo vetëm për Maqedoninë, por edhe për të gjithë rajonin, shkruajnë mediet shqiptare. "Maqedonia në NATO është mirëpritur nga të gjitha institucionet shqiptare, si sukcesi i një vendi fqinj, me të cilin gjendemi

gjeografikisht në të njëjtin rajon, por me të cilin ndajmë vizionet e së ardhmes së përbashkët euroatlantike", ka thënë Ruçi. Ndërsa Parlamenti grek të shtunën, me 153 vota "për", 140 "kundër" dhe një i përmbajtur, miratoi Protokollin për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO. Greqia është vendi i parë i NATO-s që miratoi Protokollin për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO.

Basha: Më 16 shkurt të triumfojë vullneti i qytetarëve

TIRANË, 10 SHKURT - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, zhvilloi të dielën në Vlorë takime me qytetarët, duke u bërë thirrje që të bashkohen me protestën e opozitës më 16 shkurt në Tiranë. Basha iu drejtua qytetarëve duke apeluar që "më 16 shkurt, të

gjithë duhet të bashkohen për t'i dhënë fund këtij pushteti politik". Gjithashtu, gjatë takimeve në Vlorë, Basha prezantoi alternativën e programin të ri ekonomik të PD-së, sipas tij, për rinëkëmbjen e ekonomisë së vendit. "Me

çlirimin që do i japim ekonomisë nga kjo oligarki ju do paguani vetëm 0.5% të xhiros vjetore dhe asnjë tarifë tjetër takse shtesë", tha Basha duke shtuar se "qeveria ka marrë 2 miliardë euro taksa nga shqiptarët, por nuk i ka kthyer në investime apo politika, por ua ka

ndarë 4-5 vetave, oligarkëve". "T'i japim fund ekonomisë monopoliste që i jep mundësi vetëm 4-5 njerëzve. Në radhë të dytë mbështetja për biznesmenët e vegjël. Biznesi nën 140 mijë lekë të vjetra të nxirret nga skema e TVSh-së", tha Basha.



LDK-ja thotë se Ligji për paga u bë për vota



Lideri opozitar, Isa Mustafa, ka kritikuar koalicionin qeverisës për miratimin e Ligjit për paga. Ai ka thënë se rritja e pagave në sektorin publik nuk e përmirëson standardin familjar të mjekëve, policëve, shërbyesve civilë dhe të tjerëve. Sipas kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, askush nuk duhet të mburret me veprime dhe vendime të tilla, përpos logjikës zhvatëse. Ai ka thënë se deklaratimet e zyrtarëve qeveritarë dhe politikë për rritjen e pagave po bëhen për vota

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 10 SHKURT - Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, të dielën e ka komentuar miratimin e Ligjit për paga, duke thënë se rritja e pagave në sektorin publik nuk e përmirëson standardin familjar të mjekëve, policëve, shërbyesve civilë dhe të tjerëve. Sipas tij, askush nuk duhet të mburret me veprime dhe vendime të tilla, përpos logjikës zhvatëse. Mustafa ka thënë se deklaratimet e zyrtarëve qeveritarë dhe politikë për rritjen e pagave po bëhen për vota. "Të nderuar

qytetarë, po trumbetohet se kjo Qeveri u tregua e guximshme për rritjen e pagave përmes Ligjit për pagat, me një kosto të re prej rreth 120 milionë eurosh. Thuhet se arsimtarët tanë dhe mjekët do t'i marrin pagat më të larta në regjion, se shërbyesit civilë mund të krahasohen me ata të vendeve evropiane sa i përket pagave. Për këtë flet kryetari i Kuvendit, kryeministri, shefi i GP të PDK-së, zëdhënësi i Qeverisë, ministri i Shëndetësisë. Flasin të gjithë ata që s'merren vesh me buxhetin dhe ekonominë. Flasin për vota. Sipas kësaj dhe sipas tyre, i bie se jemi më të zotët, më të dituar,

më të mirët! Të tjerët në regjion, që janë më të zhvilluar se ne, nuk po dinë t'i rrisin pagat", ka deklaruar Mustafa, duke shtuar se asnjëri prej tyre nuk flet për faktin se Kosova është vendi më i varfër në Evropë dhe në regjion e cila mezi arrin ta mbulojë importin me 10 për qind eksport. "Asnjëri prej tyre nuk flet për faktin se jemi vendi më i varfër në Evropë dhe në regjion, se mezi arrijmë ta mbulojmë importin me 10 për qind eksport, se pagat në sektorin privat, ku kemi trefishin e të punësuarve në krahasim me sektorin publik, janë shumë më të ulëta; jemi

vendi me shkallën më të lartë të papunësisë prej rreth 30 përqindësh, kurse nga rreth 2 miliardë të hyra buxhetore, mbi 1.4 miliard janë destinuar për paga dhe transferime sociale, duke ulur kapacitetin për investime dhe zhvillim", është shprehur Mustafa.

Më tutje, lideri opozitar ka thënë se nga Gjykata Kushtetuese nuk mund të pritët një vendim i drejtë lidhur me Ligjin për paga. Sipas Mustafës, më lehtë do të thoshin se vet Gjykata është më shumë jokushtetuese sesa kushtetuese. "Këtij vendimi po i atribuohet se është jokushtetues. Sa i përket kësaj, në këtë vend ka humbur kuptimi i asaj çfarë është kushtetuese e çfarë jo. Shtrohet pyetja se kush mund të presë që një Gjykatë, e kapur, Kushtetuese, e cila lejoi rritjen 100 për qind të pagave të Qeverisë, tani do të thotë se një Ligj për pagat qenka jokushtetues. Më lehtë do të

thoshin se vet Gjykata është më shumë jokushtetuese sesa kushtetuese", ka theksuar lideri i LDK-së, Isa Mustafa.

Miratimi i Ligjit për paga ka ngjallur pakënaqësi tek shumë sektorë të cilët e konsiderojnë të padrejtë trajtimin që u është bërë me anë të këtij ligji. Madje është thënë se Ligji për paga nuk do të nënshkruhet nga presidenti i vendit, Hashim Thaçi.

Presidenti në një konferencë për medie ka treguar se për këtë ligj ka pranuar dhjetëra ankesa. Thaçi ka theksuar se këtë javë do t'i shqyrtojë këto ankesa dhe se do të vendosë në pajtim me interesin e të gjithëve. "Unë sapo jam informuar se kanë ardhur shumë ankesa sa i përket Ligjit për Paga. Këtë javë Zyra Ligjore do t'i shqyrtojë dhe në përputhshmëri me interesin e të gjithëve do t'i ndërmarrim veprimet e nevojshme. Gjithçka duhet të jetë në afatet ligjore", ka thënë presidenti Thaçi.

Punëtorët e Shërbimit Korrektues sot protestojnë kundër Ligjit të pagave

PRISHTINË, 10 SHKURT - Të pakënaqur me koeficientin e pagave janë shprehur edhe punëtorët e Qendrës Korrektuese në Dubravë. Sindikalistët e Shërbimit Korrektues kanë paralajmëruar se sot (e hënë) do ta mbajnë një protestë përmes së cilës do të kërkojnë që koeficienti i pagave të tyre të lëvizë nga 1.85 në 2.2. Protesta është paraparë të fillojë para orës 08:00 dhe të përfundojë në orën 09:00. Kryetari i Sindikatës së Shërbimit Korrektues të Kosovës në nivel Kosove ka thënë për

"KosovaPress" se nëse kërkesat e tyre nuk plotësohen përmes kësaj proteste njëorëshe, ata do ta diskutojnë mundësinë edhe për protesta në Prishtinë. "Përmes ministrit të Drejtësisë kemi kërkuar që Ligji për paga të mos kalojë. Me të vërtetë është bërë një padrejtësi, kemi një punë bukur të rëndë në shumë raste, edhe ne kemi të lënduar. Të trajtohem si ashtu siç e meritojmë", ka thënë Sadikaj. Sadikaj ka shtuar se sindikalistët janë të zhgënjyer edhe nga ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri që, sipas tyre, nuk e mbajti fjalën që ua

kishte dhënë. "Ne i besuam ministrit, menduam se do ta mbante fjalën, që na kishte premtuar se do të jetë koeficienti si në Policinë e Kosovës. Ai nuk e mbajti premtimin. Ne e patëm një takim me të, por nuk ishte të gjendje të na garantonte se do të ketë rritje", ka thënë Sadikaj. Së fundmi, në Kosovë, të pakënaqur me Ligjin për paga janë shprehur disa sektorë publikë. Pakënaqësia e tyre ka rezultuar me protesta dhe greva, ku dallohen ato të mësimdhënësve dhe të mjekëve.



Shërbimi Korrektues i Kosovës
Korektivna Služba Kosova
Kosovo Correctional Service

Flet për "Epokën e re", Burim Ramadani

Kosova do të jetë anët

Zëvendësministri i Mbrojtjes, Burim Ramadani, është shprehur i bindur se Republika e Kosovës do të jetë anëtarja e 31-të e NATO-s. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se për këtë synim Kosova duhet t'i thellojë përpjekjet politike dhe diplomatike. Ramadani ka mohuar çdo mundësi që moslargimi i taksës për mallrat serbe të ndikojë në raportet e FSK-së me ShBA-në. Sipas zëvendësministrit të Mbrojtjes, këto dy gjëra nuk janë të lidhura mes vete. "Partneriteti strategjik special me ShBA-në nuk është ad hoc, por i qëndrueshëm dhe i përgjithmonshëm", ka thënë Ramadani. Në këtë intervistë dhënë me rastin e shënimit të 11-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, Ramadani ka bërë thirrje që tërë skena politike dhe institucionale të reflektojë edhe një herë përkushtimin për të avancuar, mbrojtur dhe garantuar shtetin e Kosovës të shpallur më 17 shkurt 2008

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 10 SHKURT - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Burim Ramadani, ka bërë me dije se ushtria e Kosovës po i avancon raportet me NATO-n. Ai është shprehur i bindur se Kosova do të jetë anëtarja e 31-të e NATO-s. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Ramadani ka deklaruar se Kosova duhet t'i thellojë përpjekjet politike dhe diplomatike për të arritur këtë synim. "Në të vërtetë, ne kemi më shumë kërkesa për NATO-n, sepse duam të jemi anëtarë i radhës i Aleancës Veriatlantike. Jam i bindur se Kosova do të jetë anëtarja e 31-të e NATO-s. Për këtë synim na duhet t'i thellojmë përpjekjet politike dhe diplomatike", ka thënë Ramadani. Ai ka deklaruar se në raportet e FSK-së me NATO-n nuk do të ketë ndikim mosrespektimi i kërkesës amerikane për heqjen e taksës për mallrat serbe.

Ramadani ka treguar se avancimi i FSK-së dhe institucioneve të tjera të sigurisë është i domosdoshëm dhe, sipas tij, ky proces nuk ndërlidhet me proceset e tjera. "Kjo nuk lidhet me politika të tjera. As me taksën për mallrat serbe. As nuk duhet të lidhet. Sigurisht nuk mund të flas në emër të partnerëve, porse e ritheksoj përkushtimin tonë që jemi të palëkundur për partneritetin strategjik special me ShBA-në, sidomos në politikat e sigurisë

dhe të mbrojtjes. Unë nuk shoh ndërlidhje midis temave të ndryshme, rrjedhimisht nuk shoh asnjë nevojë për shqetësime të tilla", është shprehur ai.

Zëvendësministri i Mbrojtjes ka folur edhe për aktivitetet që do t'i ketë ushtria e Kosovës me rastin e shënimit të 11-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. "Ky është përvjetori i parë i shpalljes së pavarësisë në të cilin ushtria e Kosovës do të parakalojë. Pra, do të ketë parakalim të ushtarëve të FSK-së në sheshin kryesor të Prishtinës, ashtu sikurse e ka përcaktuar këshilli organizativ ndërinstitucional për shënimin e 11-vjetorit të pavarësisë. Sidoqoftë, asgjë të jashtëzakonshme nuk do të ketë aty, vetëm shënim i përvjetorit të 11-të", ka thënë Ramadani.

"Epoka e re": Z. Ramadani, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës pritet që më 11 shkurt ta shpallë zyrtarisht konkursin publik për rekrutimin e rekrutëve. Sa rekrutë pritet të pranohen?

Ramadani: Me hyrjen në fuqi të ligjeve që mandatojnë ushtarakisht FSK-në ka filluar edhe zbatimi i planit të tranzicionit, një plan ky transparent dhe i mirëkoordinuar. Në këtë kontekst, edhe rritja e numrit të ushtarëve është pjesë e rëndësishme, sikurse edhe riorganizimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe i FSK-së. Tashmë, ashtu sikurse është planifikuar, presim interesim



arja e 31-të e NATO-s



të madh të të rinjve të Kosovës nga të gjitha komunitetet për t'u bërë pjesë e FSK-së. Procesi do të jetë transparent, ligjor dhe i saktë. Do të përzgjidhen më të mirët në konkurrim, ndërsa pastaj e tëra varet nga kapacitetet e tyre për t'i përfunduar trajnimet bazike dhe për t'i përmbushur detyrat për t'u bërë pjesëtarë të FSK-së. Në planin afatgjatë, FSK-ja do të ketë 5 000 ushtarë aktivë dhe 3 000 ushtarë rezervë. E tërë kjo do të shtrihet në një afat disavjeçarë, duke filluar që nga viti 2019. Kështu, në këtë vit do të përzgjidhen disa qindra rekrutë për t'i filluar trajnimet bazike, duke u ndarë në dy grupe të mëdha përgjatë vitit. Sidoqoftë, përkundër planeve strikte rreth numrave, këtu, mbi të gjitha, interesimi i kandidatëve të përgatitur është thelbi. Detajet sigurisht se do të bëhen publike me kohë.

"Epoka e re": Kur pritet të miratohet struktura e re e Ministrisë së Mbrojtjes dhe si do të duket ajo?

Ramadani: Sipas përcaktimeve ligjore dhe filozofisë institucionale, Ministria e Mbrojtjes do të jetë edhe më tutje Ministri e integruar me civilë dhe të uniformuar. Qëllimi është që struktura e re e Ministrisë së Mbrojtjes ta reflektojë kornizën ligjore, parimet qeverisëse dhe qëllimet për zhvillimin e arkitekturës së sigurisë kombëtare. Kështu edhe do të duket struktura e re, pra e integruar dhe që reflekton ligjin, parimet udhëheqëse dhe qëllimet për zhvillim. Kjo, sigurisht, është një punë mjaft sfiduese, por jam i bindur se riorganizimi do të shkojë tutje në kuadër të afatit të përcaktuar në planin e tranzicionit, i cili tash e shumë kohë është edhe i mirëkoordinuar, edhe publik.

"Epoka e re": Prej fillimisht të tranzicionit të FSK-së në ushtri është folur për raportet që do t'i ketë kjo forcë me KFOR-in. Në cilën fazë të zhvillimit të FSK-së pritet të shqyrtohet raporti në mes të këtyre dy forcave?

Ramadani: Me KFOR-in raportet janë në vazhdimësi duke u avancuar. Kemi marrëdhënie shumë të mira, të rregullta dhe jemi në komunikim të përditshëm. Edhe në nivelin politik, edhe në nivelin profesional. Tashmë jemi në një situatë më të zhvilluar dhe më të mirë. Si Qeveri e Kosovës besojmë se

aspektet profesionale më së miri i ndërtojnë profesionistët. Në këtë kuptim, ne kemi ftuar NATO-n që të vazhdojë të jetë aktive si përmes KFOR-it, po ashtu edhe përmes NALT-it. Në aspektin e parë, të KFOR-it, tashmë hapi i parë për thellimin e marrëdhënieve midis FSK-së dhe KFOR-it është ndërmarrë dhe zyrtarizuar. Kjo ka të bëjë më së shumti me rritjen e komunikimit të përditshëm. Jemi të kënaqur që udhëheqja e FSK-së dhe KFOR-it janë në pajtueshmëri për thellimin e këtij aspekti të komunikimit. Në aspektin e dytë, NALT-in, ne duam që ky ekip i NATO-s ta vazhdojë praninë, këshillimin dhe ndërlidhjen në mes të Kosovës dhe NATO-s. Këtë edhe e presim, që në periudhë të shpejtë ta vendosë NATO-ja, pra që gjithçka të vazhdojë njëjtë edhe në të ardhmen. Në të vërtetë, ne kemi më shumë kërkesa për NATO-n, sepse ne duam të jemi anëtarë i radhës i Aleancës Veriatlantike. Jam i bindur se Kosova do të jetë anëtarja e 31-të e NATO-s. Për këtë synim na duhet t'i thellojmë përpjekjet politike dhe diplomatike.

"Epoka e re": Mospezullimi i taksës për mallrat serbe, a mund të ndikojë në raportet e ShBA-së me FSK-në?

Ramadani: Secili shtet kalon nëpër procese të ndryshme, duke u shërbyer prioriteteve të ndryshme në të njëjtën kohë. Prandaj, edhe Kosova ka prioritete shtetërore që jodomosdoshmërisht duhen parë si të ndërthurura. Forcimi i sigurisë kombëtare, si shembull, është prioritet madhor i Kosovës, kështu avancimi i FSK-së dhe institucioneve të tjera të sigurisë është i domosdoshëm. Por, kjo nuk lidhet me politika të tjera. As me taksën për mallrat serbe. As nuk duhet të lidhet. Sigurisht nuk mund të flas në emër të partnerëve, por e ritheksoj përkushtimin tonë që jemi të palëkundur për partneritetin strategjik special me ShBA-në, sidomos në politikat e sigurisë dhe të mbrojtjes. Unë nuk shoh ndërlidhje midis temave të ndryshme, rrjedhimisht nuk shoh asnjë nevojë për shqetësime të tilla. Ne kemi ndërtuar bashkërisht institucionet deri më tash dhe bashkërisht do ta vazhdojmë forcimin e tyre. Partneriteti strategjik special me ShBA-në nuk është ad hoc, por i qëndrueshëm dhe i përgjithmonshëm. Është partneriteti i

popullit të Kosovës. Është partneriteti i Qeverisë së Kosovës. Asgjë dhe asnjëherë nuk e lëkund përkushtimin tonë në këtë partneritet.

Në anën tjetër, Kosova vazhdimisht është e sulmuar nga Serbia. Është e qartë, besoj, se Serbia duhet ta ndalë agresionin, që është rforcuar, qoftë përmes ndërhyrjes direkte brenda Kosovës, qoftë përmes agresivitetit të paprecedentë në marrëdhëniet rajonale e ndërkombëtare. Nëse Serbia nuk e ndal këtë agresion, atëherë ajo duhet të paguajë për të. Kështu, taksa është vendim reagues i Qeverisë së Kosovës. Nuk është politikë agresore ndaj një shteti tjetër, por politikë reaguese e domosdoshme për ta mbrojtur sigurinë kombëtare.

"Epoka e re": Së shpejti Kosova feston 11-vjetorin e shpalljes së pavarësisë. Cilat do të jenë aktivitetet e ushtrisë për këtë përvjetor. A do të kemi parakalim të ushtrisë?

Ramadani: Ky është përvjetori i parë i shpalljes së pavarësisë në të cilin ushtria e Kosovës do të parakalojë. Pra, do të ketë parakalim të ushtarëve të FSK-së në sheshin kryesor të Prishtinës, ashtu sikurse e ka përcaktuar këshilli organizativ ndërinstitucional për shënimin e 11-vjetorit të pavarësisë. Sidoqoftë, asgjë të jashtëzakonshme nuk do të ketë aty, vetëm shënim të përvjetorit të 11-të. Për më shumë se kaq, besoj se në aspektin politik dhe të debatit publik mbi të ardhmen e Kosovës, e tërë skena politike dhe institucionale duhet ta reflektojë edhe një herë përkushtimin për të avancuar, mbrojtur dhe garantuar shtetin e Kosovës të shpallur më 17 shkurt 2008.

Kosova e 17 shkurtit 2008 është e vetmja që siguron stabilitet dhe paqe në rajon. E vetmja që garanton prosperitet për qytetarët e Kosovës, të të gjitha komuniteteve, dhe që siguron të ardhmen e sigurt të gjithëve. Në 11-vjetorin e shpalljes së pavarësisë duhen rikujtuar dhimbjet e tragjeditë që populli i Kosovës ka kaluar në të kaluarën jo të largët. Ne, si politikë e institucione, por edhe si qytetarë, duhet të rizotohemi për shërbim ndaj atdheut. Secili nga ne individualisht, politikisht dhe institucionalisht kemi obligim kushtetues, kombëtar e qytetar të sigurojmë që Kosova e 17 shkurtit do të jetojë përgjithmonë.

Kosova nuk mund 't'ia mbyllë' derën UNMIK-ut

PRISHTINË, 10 SHKURT - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ka mbetur mision simbolik por, përderisa të jetë në fuqi Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara, ky mision do të ekzistojë në Kosovë, vlerësojnë njohësit e çështjeve politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare. Sipas tyre, UNMIK-u nuk është i zhveshur nga pushteti, pavarësisht që nuk e ka shfrytëzuar asnjëherë atë pushtet për t'i rrëzuar vendimet e institucioneve të Kosovës.

Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, profesor i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" që në aspektin politik Rezoluta 1244 e OKB-së është tërësisht joefektive dhe UNMIK-u tashmë ka një mision mjaft të cunguar. Sipas tij, në mënyrë efektive UNMIK-u nuk kryen asnjë punë, përveç atyre të komunikimit për çështje të sigurisë me botën e jashtme që, siç thotë ai, është pasojë e moskonsolidimit të tërësisht të shtetësisë së Kosovës në planin ndërkombëtar. Megjithatë, Hasani thekson që, në aspektin juridik, UNMIK-u vazhdon të ekzistojë. "UNMIK-u ekziston dhe ende është në fuqi, sepse Rezoluta 1244 (e OKB-së) është në fuqi dhe bën pjesë në rendin juridik të Kosovës përmes Deklaratës së Pavarësisë, me të cilën Kosova, kur e ka shpallur pavarësinë, në mënyrë shprehimorë ka marrë zotim të njëanshëm ndërkombëtar, me të cilin respekton Rezolutën 1244, për aq sa ajo nuk bën ndesh me konceptin e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Do të thotë, në këtë kuptim duhet parë aspekti juridik", ka thënë Hasani.

(Mos)komunikimi me UNMIK-un

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tri ditë më parë ka deklaruar se institucionet e Kosovës nuk komunikojnë më me UNMIK-un. "Tash, ne si Kosovë, e kemi shkëputur komunikimin me UNMIK-un. Pra, nuk po komunikojmë më me të", ka thënë Haradinaj. Për më shumë, zyrtarët e kabinetit të kryeministrit Haradinaj kanë theksuar se Qeveria e Kosovës e ka shkëputur edhe "komunikimin e kurtuazisë" dhe që nuk shohin "asnjë interes që Kombet e Bashkuara t'i përfaqësojë një strukturë që quhet UNMIK".



Politologu Ramush Tahiri, duke folur për "Radion Evropa e Lirë", vlerëson se deklarata e kryeministrit Haradinaj lidhur me UNMIK-un është krejtësisht politike dhe animon dhe krijon një opinion të caktuar, por nuk mund të jetë deklarata që sjell vendim juridik. "Deklarata e kryeministrit Haradinaj politikisht dëshiron të arrijë një qëllim të caktuar dhe të japë porosi që ky mision e ka përfunduar punën e vet dhe që më në Kosovë nuk është i nevojshëm. Së dyti, dëshiron të theksojë që Kosova ka kryeministër të fuqishëm dhe një qeveri shumë të përkushtuar, e cila është partnere para faktorit ndërkombëtar dhe e cila merr vendimet në mënyrë sovranë për territorin e vet. Efekti juridik është zero në këtë çështje", ka vlerësuar Tahiri. Por, Halil Matoshi, këshilltar politik i kryeministrit Haradinaj, në një bisedë me "Radion Evropa e Lirë" ripërsërit qëndrimin e Qeverisë së Kosovës, duke theksuar se kjo qeveri nuk e njeh UNMIK-un. "Praktikisht, Qeveria e Kosovës nuk e njeh më një strukturë të tillë në vendin tonë. Ata janë një mision që është relik i para pavarësisë së Kosovës, do të thotë i Rezolutës 1244 dhe mund të qëndrojnë si mysafirë. Nuk i nguc askush, por ata nuk kanë ndonjë rol në sistem, përkatësisht në qeverisjen në vend, sepse tash Kosova është një vend sovran dhe merr vendime sovranë", ka thënë Matoshi. Në anën tjetër, zyrtarët e

UNMIK-ut, por edhe zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Qeverisë së Kosovës, kanë bërë me dije s komunikimi i ndërsjellë nuk është shkëputur, e sidomos kur bëhet fjalë për fushën e sigurisë.

Zyra e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë funksionon edhe si zyrë komunikimi ndërmjet institucioneve të Kosovës me Agjencinë Ndërkombëtare të Policisë-Interpol.

Zëdhënësja e UNMIK-ut, Sanam Dolatshahi, i ka thënë "Radion Evropa e Lirë" se UNMIK-u vazhdon ta luajë edhe më tej këtë rol "si ndërmjetësues me Interpolin, në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe EULEX-in", po nuk ka dashur t'i komentojë rastet specifike. Ministria e Punëve të Brendshme në Kosovë ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë se vazhdon të bashkëpunojë me Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë sa i përket fushës së sigurisë. Sipas zyrtarëve të kësaj ministrie, "me Interpolin komunikohet në baza ditore dhe rreth 40 për qind të këtij komunikimi zhvillohet përmes UNMIK-ut. Në rreth 60 për qind të rasteve të tjera Policia e Kosovës shfrytëzon linja të tjera të komunikimit".

Një marrëveshje Kosovë - Serbi e shuan UNMIK-un

Misioni i UNMIK-ut vepron sipas Rezolutës 1244 të OKB-së

e cila ka qenë kompromis midis vendeve perëndimore dhe Rusisë për t'i dhënë fund konfliktit në Kosovë. Ky mision është neutral ndaj statusit të Kosovës. UNMIK-u, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008, i ka bartur të gjitha kompetencat tek institucionet vendore. Por, politologu Tahiri thotë se institucionet e Kosovës nuk mund të ndikojnë drejtpërdrejt në heqjen e misionit UNMIK nga Kosova. "Ky mision hiqet me të njëjtën procedurë me të cilën është vendosur. Do të thotë, ky mision hiqet me heqjen e Rezolutës 1244. Faktikisht, derisa të jetë Rezoluta 1244, UNMIK-u i çon raportet te sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i çon raportet për Këshillin e Sigurimit dhe i njofton vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara për situatën dhe gjendjen në Kosovë", ka theksuar Tahiri.

Ndërkaq, profesor Hasani thekson se rezoluta të ngjashme me Rezolutën 1244, si dhe misionet të ngjashme si UNMIK-u, ka përplot nëpër botë, të cilat zgjasin me dekada të tëra dhe rreth 40 për qind të këtij komunikimi zhvillohet përmes UNMIK-ut. Në rreth 60 për qind të rasteve të tjera Policia e Kosovës shfrytëzon linja të tjera të komunikimit".

Kosovës. "Evropa ka ndikim primar për sa i përket integritetit të Kosovës në strukturat rajonale, në shumë aspekte që lidhen me dialogun. Sipas Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme, Evropa është lehtësuese dhe ndërmjetësuese e dialogut Kosovë - Serbi. Në momentin që të arrihet një marrëveshje ndërmjet palëve, atëherë edhe Këshilli i Sigurimit në mënyrë automatike çdo marrëveshje rajonale që bëhet nën aranzhimet që quhen rajonale, siç është Bashkimi Evropian, duhet ta legalizojë pa asnjë vërejtje dhe ta përmbyllë atë proces", ka theksuar Hasani. Sidoqoftë, Prishtina zyrtare ka kërkuar edhe më herët që misioni i UNMIK-ut të reformohet dhe të mbetet vetëm si zyrë përfaqësuese e OKB-së në Kosovë.

Së fundmi, në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, ku është raportuar dhe diskutuar për situatën në Kosovë, ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në OKB, Jonathan Cohen, ka thënë se UNMIK-u e ka përmbushur misionin e vet dhe se tashmë ka kaluar koha për zvogëlimin e misionit të tij. Ngjashëm është shprehur edhe ambasadori i Gjermanisë në OKB, Kristof Hojsgen, i cili ka bërë thirrje për një vlerësim strategjik të misionit të UNMIK-ut në përputhje me gjendjen në terren, duke theksuar se mjaft detyra të UNMIK-ut mund t'i marrin organizatat e tjera.

Është shënuar 12-vjetori i protestës së 10 shkurtit, në të cilën kanë humbur jetën dy aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, Arben Xheladini dhe Mon Balaj

Në 12-vjetorin e vrasjes, kërkohet drejtësi për Arbenin dhe Monin

Ndonëse janë bërë dymbëdhjetë vjet nga protesta e 10 shkurtit, në të cilën janë vrarë aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, Arben Xheladini dhe Mon Balaj, ende askush nuk ka dalë para drejtësisë. Kështu është thënë të dielën gjatë homazheve të pllaka përkujtimore e Arben Xheladinit dhe Mon Balajt. Deputeti i Vetëvendosjes, Glauk Konjufca, ka thënë se është e dhimbshme që ende nuk kanë dalë para drejtësisë ata që kanë vrarë Arbenin dhe Monin

**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 10 SHKURT - Me disa aktivitete është shënuar të dielën 12-vjetori i protestës së 10 shkurtit të vitit 2007, në të cilën kanë humbur jetën dy aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Arben Xheladini dhe Mon Balaj. Me këtë rast drejtuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë bërë homazhe te varrezat dhe te pllaka përkujtimore e Arben Xheladinit dhe Mon Balajt. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka thënë se është e dhimbshme se si dymbëdhjetë vjet pas vrasjes së Arbenit dhe Monit ende nuk ka drejtësi. "Në protestën e 10

shkurtit të vitit 2007, në momentin kur qytetarët arritën këtu, policia e UNMIK-ut u doli përballë protestuesve dhe ua mbylli rrugën. Ne e kishim paralajmëruar një protestë paqësore e cila pastaj u kthye në gjakderdhje nga policia e dhunshme e UNMIK-ut. Policët e UNMIK-ut filluan të qëllonin me pushkë të gjata në drejtim të protestuesve. Si pasojë e kësaj gjetën vdekjen Arben Xheladini dhe Mon Balaj", ka thënë Konjufca, duke shtuar se Mon Balaj dhe Arben Xheladini janë heronjtë e pasluftës të cilët kanë rënë për liri dhe vetëvendosje. "Historia na ka treguar që Kosova ka pasur edhe dëshmorë të pasluftës, siç janë Arben Xheladini dhe Mon



Balaj. Është shumë e dhimbshme që nuk e kemi Monin e Arbenin në mesin tonë, por është e dhimbshme që nuk pati kurrë drejtësi. Njësitë prej 11 rumunëve u kthye në vendin e vet dhe krejt çka është thënë nga UNMIK-u ka qenë gatishmëria për kompensim material dhe kjo na fyen të gjithëve. Ne mund të

qetësohemi sadopak kur ata që e kanë bërë krimin të jenë prapa grilave", ka theksuar ai. Ndërkohë Fahri Balaj, vëllai i Mon Balajt, ka kritikuar institucionet shtetërore që nuk kanë bërë asgjë për të sjellë para ligjit kryesit e krimit të 10 shkurtit. Sipas tij, institucionet kurrë nuk kanë shprehur gatishmëri që të kërkojnë llogari për këto vrasje. "Momenti për familjarët ka qenë shumë i rëndë, nuk e kemi prituri që të vdesin ashtu në mënyrë politike. Nuk i konsideruan kurrë si qytetarë të vet, që të kërkojnë llogari nga institucionet rumune. Ne kemi ngrehur padi, por institucionet kurrë nuk shprehën gatishmëri që të kërkojnë llogari për këtë. Ne jemi të indinjuar me mosgatishmërinë e shtetit dhe institucioneve që të mos i sjellin para ligjit kryesit e krimit", ka deklaruar Fahri Balaj. 12-vjetorin e vrasjes së Arben Xheladinit dhe Mon Balajt e ka përkujtuar edhe anëtari i Kryesisë së Partisë Socialdemokrate (PSD), njëherësh deputeti i Kuvendit të Kosovës, Dardan Molliqaj.

Ai ka thënë se Moni dhe Arbeni para 12 vjetësh u angazhuan duke protestuar për përparim, liri dhe barazi por, sipas Molliqajt, pushteti i vrau sepse nuk e duronte idenë që qytetarët të angazhohen vetë për fatin e tyre. Ai ka thënë se ende askush nuk është dënuar për vrasjen e Monit dhe Arbenit. "Progresi, liria dhe barazia, shumë shpesh hasin në rezistencën e pushtetit të padrejtë që synim ka ruajtjen e një gjendjeje të caktuar. Moni dhe Arbeni para 12 vjetësh u angazhuan duke protestuar për progres, liri dhe barazi. Pushteti i vrau sepse nuk e duronte idenë që qytetarët të angazhohen vetë për fatin e tyre. Pushteti nuk e donte demokracinë dhe nuk pranonte mendim ndryshe. Sot e asaj dite askush nuk është dënuar për vrasjen e Monit dhe Arbenit. 10 shkurti, do të na e përkujtojë gjithmonë që Kosova sikur që ka pasur regjime jodemokratike dhe autoritare, po ashtu ka pasur qytetari aktive që i ka përballuar këto regjime", ka shkruar Molliqaj në llogarinë e vet në "Facebook".



30 ditë paraburgim për pjesëtarin serb të FSK-së që keqpërdori seksualisht të miturën

GJILAN, 10 SHKURT (ER) - Gjykata Themelore në Gjiilan ka njoftuar përmes një komunikate se ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore të Gjiilanit, duke i caktuar masën e paraburgimit prej tridhjetë ditësh të pandehurit M. S. I pandehuri dyshohet se më 7 shkurt 2019, në fshatin Mogillë, Komuna e Vitisë, ka keqpërdorur seksualisht të miturën nën moshën 16 vjeçare N. K. Pjesëtari i FSK-së, i minoritetit

serb, është ndaluar nga autoritetet pas dyshimeve për "keqpërdorim seksual". "Me këto veprime i pandehuri M. S. ka kryer veprën penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16-vjeçare, nga neni 235, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, lidhur me nenin 232, paragrafi 3, nënparagrafi 3.7 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Gjyqtari i procedurës paraprake në Departamentin e Krimeve të Rënda, pas shqyrtim-

it të shkresave të lëndës, ka konsideruar se janë përmbushur kushtet ligjore për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit, pasi për këtë veprë parashihet një dënim mjaft i rëndë, si për natyrën dhe ndjeshmërinë e kësaj vepre, gjithashtu edhe për ndikimin tek e dëmtuara, gjë që do të pamundësonte rrjedhën normale të procedurës penale", është bërë me dije në njoftimin e gjykatës.



Bisedë me kryetarin e Shoqatës së Eksportuesve të Kosovës, Nexhat Hasani

Hasani: Taksa ndaj Serbisë dhe Bosnjës të mos hiqet



Kryetari i Shoqatës së Eksportuesve të Kosovës, Nexhat Hasani, ka thënë se nga dita e marrjes së vendimit të Qeverisë së Kosovës për vënien e taksës 100 për qind ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës, eksportuesit e Kosovës kanë shënuar përparim si në eksport, po ashtu dhe në numrin e të punësuarve. Sipas tij, pos efekteve politike, kjo taksë në masë të madhe ka dhënë efekte ekonomike dhe ka vetëdijësuar edhe konsumatorët

like, tash kemi rritje kryesisht në fushën e konsumit si te verërat, pijet dhe ushqimet në përgjithësi", ka thënë ai. Hasani ka deklaruar se eksportuesit e Kosovës tani kanë rritur operimin e tyre kryesisht në vendet e regjionit dhe CEFTA-s. "Prej vënies së taksës, kryesisht eksportuesit kanë arritur që të kenë shtrirje më të madhe në vendet e regjionit dhe CEFTA-s", është shprehur Hasani.

I pyetur se për cilat mallra është vërejtur vakum apo është hasur në vështirësi të zëvendësimit, ai ka thënë se janë kryesisht mallrat e higjienës, por për të cilat është bërë zgjidhja e zëvendësimit. "Janë disa mallra të higjienës të cilët në sasi të konsiderueshme më parë i kemi importuar nga Serbia, të cilat tani mund t'i zëvendësojmë me produkte nga Maqedonia ose Shqipëria", ka thënë ai.

Kryetari i Shoqatës së Eksportuesve të Kosovës, Nexhat Hasani, ka theksuar se eksportuesit e Kosovës vazhdojnë të përballen me importimin e lëndës së parë dhe pajisjeve të teknologjisë. "Akoma kemi

probleme sa i përket doganës, përkatësisht importimit të lëndës së parë dhe pajisjeve teknologjike, që është në disfavor të atmosferës biznesore. Po ashtu, ende kemi vështirësi për importimin e pjesëve rezervë të lëndës së parë dhe ambalazheve, mirëpo dalëngadalë shihet se po punohet për evitimin e këtyre probleme", ka thënë Hasani.

Ai ka bërë apel që taksa ndaj Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës të mos hiqet pasi, sipas tij, është në disfavor të interesave biznesore. "Sipas mendimit tim, taksa duhet të mbetet në mënyrë që mos të marrim mallra nga Serbia dhe Bosnje Hercegovina, kur dihet se kjo taksë na ka ndihmuar mjaft shumë për rritjen e prodhimit të konsumatorëve dhe qytetarëve në përgjithësi. Pra, taksa ka efekte shumëdimensionale", është shprehur Hasani.

Ai ka thënë se gjendja e eksportit

momentalisht nuk është e kënaqshme mirëpo, sipas tij, pritshmëritë janë më të mëdha në sajë edhe të rimëkëmbjes së Ferronikelit. "Nuk është i kënaqshëm niveli i eksportit pasi sillet rreth 400 milionë euro. Besoj se këtë vit do të kemi rritje më të madhe, sepse kemi edhe fushën e industrisë metalike, që pati rënie nga 150 milionë euro dhe eksporteve në 30-40 milionë euro në saje të krizës që kishte. Tash pas rimëkëmbjes besoj se në këtë fushë do të kemi rreth 100 milionë euro eksporte", ka deklaruar Hasani.

Ndërkaq sa i përket bashkëpunimit me Shqipërinë, konkretisht lehtësirave nga porti i Durrësit, Hasani ka thënë se ende ka vështirësi të procedurave administrative. "Porti i Durrësit është një lehtësim i madh për ne, sepse janë ende disa probleme të natyrës administrative dhe këto do të duhej të tejkaloheshin. Qeveritë e të dyja vendeve duhet t'i identifikojnë mirë problemet e përbashkëta dhe jo vetëm të mbajnë takime dhe konferenca mediale", ka thënë kryetari i Shoqatës së Eksportuesve të Kosovës, Nexhat Hasani.

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 10 SHKURT - Kryetari i Shoqatës së Eksportuesve të Kosovës, Nexhat Hasani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se nga dita e marrjes së vendimit të Qeverisë së Kosovës për vënien e taksës 100 për qind ndaj mallrave të Serbisë dhe të Bosnjë Hercegovinës, eksportuesit e Kosovës kanë shënuar përparim. Sipas tij, rritja e prodhimit është shënuar kryesisht tek verërat, mallrat ushqimorë dhe pijet. "Prej vënies së taksës 100 për qind

ndaj mallrave me origjinë serbe dhe të Bosnjë Hercegovinës, mund të themi se eksporti ka shënuar progres, pasi është rritur dukshëm prodhimtaria vendore dhe mundësitë për të eksportuar janë dukshëm më të mëdha. Nga informatat dhe kontaktet që kam me eksportuesit, në të gjitha kompanitë thuajse është dyfishuar eksporti dhe, po ashtu, është rritur edhe numri i të punësuarve", ka thënë Hasani, duke shtuar se pos që ka rritje në tregun vendor, ka edhe përfitim të tregjeve të reja. "Më parë kishim rritje kryesisht tek industria e drurit dhe ajo meta-

Akademiku shqiptar: Pasuritë e 'Trepçës' kapin vlerën prej 500 miliardë dollarësh

PRISHTINË, 10 SHKURT - Në emisionin "Arena" të gazetarit shqiptar Dritan Hila është diskutuar rreth situatës politike në Kosovë, idesë për ndarje dhe ndërmarrjes së "Trepçës", debat ky që është riaktivizuar pasi Kuvendi i Kosovës ka miratuar statutin e ri të "Trepçës". Një vendim i tillë i Kosovës rreth "Trepçës" ka nxitur reagime të ashpra nga Serbia, gjithashtu është kërkuar edhe ndërhyrja dhe reagimi i Bashkimit Evropian.

Ka qenë zëdhënësja e kryenegociatore Federica Mogherini, Maja Kocijançiq, e cila ka ngritur tensionet edhe më tutje, duke

thënë se rreth "Trepçës" do të diskutohet edhe në dialogun e Brukselit, që u kundërshtua fort nga krerët e shtetit të Republikës së Kosovës, duke thënë se nuk ka çfarë të diskutohet për pasuritë e Republikës së Kosovës në Bruksel me Serbinë.

Por pse e gjithë kjo luftë e Serbisë rreth "Trepçës".

Në emisionin "Arena", që transmetohet në televizionin shqiptar "Ora News", profesori dhe akademiku Apollon Baçe, i cili ka qenë edhe ish-korrespondent i "Deutsche Welle"-s, ka treguar se, bazuar në librin e Paul Stuartit, pasuritë minerale të "Trepçës" shkojnë diku në vlerë prej 500

miliardë dollarëve. "Bazuar në librin e Paul Stuartit 'Trepca Mining Complex', 80 lloje të mineraleve, tre e katërta (¾) e tabelës së Mendeljevit, lantanide, kobalt, kadmium, argjend, ari, 60 milionë tonë plumb që janë 150 miliardë dollarë, 40 milionë tonë zink që janë 140 miliardë dollarë, 50 mijë tonë argjend që janë 30 milionë dollarë, shtuar mineralet dhe kristalet, vlera e saj është 500 miliardë dollarë", ka thënë akademiku Baçe. Ai ka treguar se si këto pasuri të "Trepçës" janë shfrytëzuar nga Gjermania e Hitlerit për ndërtimin e mjeteve të luftës.



Autostrada Prishtinë - Han i Elezit përfundon në qershor

PRISHTINË 10 SHKURT (ER) - 152 ditë shtesë i dha Ministria e Infrastrukturës "Bechtel Enkas" kur nënshkroi anekskontratën e tretë më 5 shtator 2018 për autostradën Prishtinë - Han i Elezit.

Instituti Demokratik i Kosovës/Transparency International Kosova në vazhdimësi ka përcjellë deklaratat e ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, lidhur me përfundimin e punëve lidhur me këtë kontratë. Në një konferencë për media, Diana Metushi-Krasniqi nga KDI-ja ka bërë edhe prezantimin e kësaj anekskontrate që vërteton një

gjë të tillë. Ajo ka theksuar se në anekskontratë qartazi mund të shihet se Neni 5 zgjat kohën e përfundimit për 152 ditë, përdorin Neni 9 obligon Qeverinë t'i mbarojë të gjitha shpronësimet dhe t'i garantojë kontraktorit qasje në vendpunishte për t'i përfunduar punët. "Për t'i kuptuar termat e përdorur në anekskontratë duhet t'i referohemi edhe kontratës kryesore, ku neni 8.2, kohën e përfundimit e definojnë si: Kontraktori do t'i kompletojë të gjithë punimet, ta përfundojë secilën pjesë (nëse ka) brenda kohës për përfundimin e

punimeve ose seksioneve (pjesëve), duke përfshirë: (a) arritjen e kalimit të testeve pas përfundimit, dhe (b) përfundimin e të gjitha punëve të deklaruar në kontratë si të domosdoshme që punët apo pjesët (seksionet) të konsiderohen si të përfunduara me qëllim të pranim-dorëzimit të definuar në nënklausolën 10.1 [Pranim-dorëzimi i punëve dhe seksioneve]", ka shtuar më tej. Metushi-Krasniqi ka potencuar se KDI-ja kërkon nga ministri Lekaj që në vend të mohimit të gjetjeve të KDI-së, të japë sqarime publike se si është rrit-

ur detyrimi i Qeverisë së Kosovës nga 14.78 milionë në vitin 2016 në shumën prej 53.1 milionë euro në vitin 2017. Sipas saj, si rezultat i vonësve për realizimin e pagesave ndaj "Bechtel Enkas", Qeveria e Kosovës, bazuar në kontratën bazë, duhet t'i paguajë kontraktorit një kosto shtesë. Anekskontrata, të cilën e ka publikuar KDI-ja, pranon detyrimet e Qeverisë ndaj "Bechtel Enkas", por nuk definojnë se çfarë mbulon kjo shumë. Neni 3 i kësaj anekskontrate definojnë se 53.1 milionë euro është vlera e zgjatjes së afatit të

kontratës për periudhën 18 janar - 31 dhjetor 2018, ndërsa nenet 6, 7 dhe 8 thonë se me nënshkrimin e kësaj anekskontrate kontraktori pranon se nuk do të ketë pretendime lidhur me mungesat buxhetore përgjatë viteve 2014-2018. KDI-ja u ka bërë thirrje organeve të drejtësisë që t'i hetojnë në mënyrë eksplicite arsyet e humbjes së 53.1 milionë eurove të qytetarëve të Kosovës si dhe përlllogaritjes së shumës prej 53.1 milionë eurove për vazhdim të kontratës 18 janar - 31 dhjetor 2018, përkatësisht 1 qershor 2019.

Bekim Jashari: Jam i lumtur që u kam dalë në ndihmë familjeve sociale me dru

SKENDERAJ, 10 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se është i lumtur që u ka dalë në ndihmë familjeve me raste sociale me dru, për t'i kaluar ditët e mbetura të dimrit. Kjo deklaratë e Jasharit ka ardhur pas akuzave se kryetari i Skenderajt nuk po u ndihmon familjeve skamnore me dru. "Më shumë sesa disa individë që mund të numërohen në gishta, të cilët, përveç zhurmës së panevojshme në publik, duke u munduar, siç thotë populli 'të nxjerrin dhjam prej pleshiti', nuk njihen për asgjë tjetër, jam i lumtur që sadopak kemi mundur t'u dalim në ndihmë

familjeve - raste sociale me dru për t'i kaluar ditët e mbetura të dimrit. As më pak e as më shumë se 120 metra kub dru, të cilat janë shpërndarë për dyzet familje, ku secila prej tyre ka përfituar nga 3 m³", ka thënë Jashari. Sipas tij, kjo është bërë e mundur falë vullnetit të mirë të njerëzve të mirë si puna e Shpëtim Arifit, Avdullah Lushtakut dhe Bedri Zejnullahut, të cilët i ka falënderuar në emër të Komunës së Skenderajt. "Pra, ata individë zhurmashin, në vend se t'i gëzohen lajmit për këtë ndihmë, zgjedhin zhurmën dhe pleshitat", ka thënë Bekim Jashari, kryetar i Komunës së Skenderajt.



Kaçaniku bëhet gati për shënimin e 11-vjetorit të pavarësisë së Kosovës

Kaçanik, 10 shkurt (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, Këshilli Organizativ i kësaj komune, për shënimin e 11-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, me moton "Kosova nder dhe

detyrë", ka hartuar agjendën e aktiviteteve që do të organizohen, duke filluar nga 15 shkurti deri më 17 shkurt 2019. Gjatë këtyre ditëve do të organizohen aktivitete letrare, kulturore artistike, përkujtimore dhe aktivitete

sportive. Siç ka njoftuar Komuna e Kaçanikut, këto aktivitete do të përmbillen me akademinë festive në Shtëpinë e Kulturës "Xheladin Kurtaj" në Kaçanik më 17 shkurt, duke filluar nga ora 12:00.

Arrestohen pesë persona në Ferizaj, kapen me 220 kilogramë substancë narkotike

FERIZAJ, 10 SHKURT (ER) - Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda, ka njoftuar se, pas një hetimi disamujor, në bashkëpunim me Njësitin Antidrogë, janë kryer kontrollë në dy lokacione me ndihëm e Policisë Speciale të Kosovës, si dhe pas kontrollit në këto dy lokacione, të shtunën në mbrëmje janë konfiskuar 220 kilogramë substancë narkotike e llojit marijuanë që dyshohet se

ka ardhur nga shteti i Shqipërisë dhe, gjithashtu, janë konfiskuar tri vetura.

Po ashtu, janë arrestuar pesë persona për shkak se ekziston dyshimi i bazuar se të njëjtit, duke vepruar si anëtarë të grupit të organizuar mirë, kishin për të kryer vepër penale "blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge", nga neni 273, paragrafi 2, lidhur me nenin 281 të Kodit

Penal të Republikës së Kosovës. Personat e arrestuar dyshohet se këtë sasi të marijuanës kanë pasur për qëllim ta transportojnë jashtë shtetit të Kosovës. Prokuroria e Ferizajt njofton se ende janë duke vazhduar hetimet për pjesën e grupit të cilët ende janë në arrati. Prokuroria Themelore në Ferizaj njofton se me urdhër të Prokurorit të Shtetit pesë të arrestuarve u është caktuar masa e ndalimit për 48 orë.



Rregullohen shportat e dëmtuara të mbeturinave në parkun 'Shtigjet e ecjes'

THERANDË, 10 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se janë rregulluar shportat e mbeturinave në parkun "Shtigjet e ecjes". Po ashtu, ai ka bërë me dije se, pas rregullimit të këtyre shportave, është bërë edhe pastrimi i ambientit në këtë zonë. "Shportat e dëmtuara nga ata që

nuk i duan të mirën vendit u rregulluan sërish nga njerëzit e vullnetit të mirë, për ta ofruar ambientin që qytetarët të ecin dhe relaksohen në 'Shtigjet e ecjes'. U pastrua edhe ambienti nga mbeturinat e hedhura, të cilat mund ta dëmtonin imazhin e mirë që e duam të gjithë. Roja më i mirë dhe më i sinqertë është qytetari.

Ai e ndërton vetëdijesimin dhe dashurinë për rregull, kur e dëshmon hapur duke dhënë këshilla ose duke denoncuar tek institucionet shkelësit e ligjit. Unë e besoj në këtë. Punoj çdo ditë ngaqë e di se bashkë do ta realizojmë Komunën e Therandës me ambient të pastër kudo", ka thënë Muharremaj.

'Krizja në Kosovë, zgjidhja ende e largët'



Nga Jakup KRASNIQI

Ky titull është i një shkrimi (analize) të DW i 9 shkurtit 2019, që tek ne e sollën mediet tona (portalet). Sigurisht se nuk pajtohem me pjesën e parë të titullit "Krizja në Kosovë", kur dihet se në 30/40 vjetët e fundit kriza në k'të pjesë të Evropës është e shkaktuar nga Serbia dhe kriza vazhdohet nga politikat që zihen e përzihen në kuzhinën serbe e ruse dhe se kriza i tejkalon goxha shumë kufijtë e Kosovës, pra jo edhe me fajin e Kosovës. Mbase titulli do t'i shkonte shumë më mirë po të thuhej: Kriza në Ballkanin Jugperëndimor, "zgjidhja ende e largët". Pasi Ballkani do të vazhdoi të ketë kriza të karakterit nacionalist edhe aty ku zjarrit nacionalist i është qitur një kapak ngulfatës, e të cilit i duhet një zgjidhje afatgjatë të bazuar

në vlera evropiane. Kaq sa i përket pjesës së parë të titullit. Është interesant edhe përshkrimi që i bënë Kosovës, për të cilën gjë autori shkruan: "Kosova vazhdon të jetë një nga shtetet më të korruptuara. Mediat dhe drejtësia kanë ngelur varur në klanet e politikës. Kontrabanda e armëve, drogës dhe qenieve njerëzore janë "sektorët ekonomikë" më të rëndësishëm". Për këtë edhe nuk kam shumë vërejtjeje, por kjo gjendje është që nga koha e UNMIK-ut dhe EULEX-it dhe i gjithë problemi është i shtresuar ndër vite dhe ka pasur e mbase edhe ka një bashkëveprimi me krimin e organizuar jashtë kufijve të Kosovës. Një gjë duhet të thuhet, ajo që nënvizova dhe e shkëputa nga shkrimi i DW për Kosovën duhet të lexohet e rilexohet nga drejtuesit e pozitës e të opozitës, sidomos nga të parët, që ta shohin pa syza, ashtu si po e shohin të tjerët Kosovën. Kjo vlen sidomos për ata që kanë qeverisur gjatë pas Pavarësisë. Sigurisht që këtë duhet ta ketë parasysh cilido që merr përgjegjësinë për të qeverisur. Dhe gjendja është përshkruar saktë dhe për këtë gjendje flasin

shumë faktor e në mesin e të tyre edhe largimi i vazhdueshëm i qytetarëve nga Kosova dhe rënia drastike e numrit të banorëve gjithandej vendit tonë. Qytetarët po largohen se nuk po shohin as perspektivë e as siguri për jetën. Ata që e kanë marr përgjegjësinë për të qeverisur vendin, duhet t'i marrin masat e nevojshme për t'i ndryshuar në themel politikat e planifikimit e të drejtimit. Por, këtë nuk mund ta bëjnë me kapacitetet politike, intelektuale e profesionale që i kanë ofruar gjatë dhjetëvjetëshit të Pavarësisë. Ata duhet ta dinë se me politikat që i bëjnë me njerëzit e "lepe peçeve" as qeveriset vendi dhe as bëhen ndryshimet progresiste e zhvillimore. Kushdo që nuk e sheh këtë është më shumë se mendjeshkurtër.

Ajo që nuk mund të pajtohem është edhe fakti se për Serbinë po thuhet: "Në Serbi gjendja është e njëjtë, megjithëse vendi është zyrtarisht kandidat për t'u pranuar në BE. Komisioni i BE-së, ka parashikuar madje vitin 2025, si datë e mundshme pranimit". Edhe në Serbi gjendja është e njëjtë, si në Kosovë (mbase edhe më keq), por ajo

është kandidate për integrim në BE, ndërsa Kosova nuk e ka as liberalizimin e vizave edhe pse i ka plotësuar të gjitha kushtet, është thënë po nga BE-ja. Kjo është një dëshmi tjetër se disa vlera të BE-së janë ngatërruar diku në mes 28 vendeve të saj! Në vazhdim është goxha interesant përshkrimi që i bëhet Vuçiqit, për të cilin thuhet: "Vuçiqi ka shtatë vjet që qëndron në pushtet. Kjo falë premtimeve që i ka bërë Berlinit, Uashingtonit dhe Brukselit se do të punojë për një zgjidhje në çështjen e Kosovës. Për këtë Perëndimi i la dorë të lirë në politikën e brendshme. Askush nuk ka ushtruar kritika të ashpra që Vuçiqi ka ndërtuar një sistem autokratik pushteti". Nuk me vije keq që Vuçiqit i është len të livadhis në Serbi, por kush mund të thuhet se diçka e tillë nuk i është len edhe ndonjërit nga të tanëve? Të cilët nuk përshkruhen më mirë sesa Vuçiqi. Pasi autori i shkrimit vijon: "Edhe në Kosovë udhëheqësit politikë nuk janë të interesuar në ndonjë paqe afatgjatë me fqinj, Serbinë. Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj janë rritur në luftën e armatosur

kundër Serbisë". Edhe pse, ndonjëri nga këta tanët, gjatë këtyre gjashtë-shtatë viteve është munduar me mish e shpirt ta përmbyllë paqen me Serbinë edhe me kushtin e zvogëlimit gjeografik të Kosovës?! Pse nuk u pajtova me përshkrimet e fundit që autori i ka bërë Vuçiqit dhe udhëheqësve të Kosovës? Jo vetëm pse Vuçiqi në Serbi nuk është i vetmi, ka edhe plotë të tjerë si ai, por edhe për faktin se nëse "zgjidhja është ende e largët", përgjegjësia duhet të kërkohet vetëm në Beograd, pasi Kosova ka bërë shumë kompromise për t'i normalizuar marrëdhëniet me Serbinë. E kompromisi më i madh është bërë me Dokumentin e Ahtisarit i cili ka pasur edhe bekimin e Grupit të Kontaktit pjesë e të cilit ka qenë edhe Rusia. Ndonëse në Bisedimet e mbikëqyruara nga Brukseli është shkruar shumë përtej ati dokumenti. Sigurisht, titulli më i mirë do të duhej të ishte: Kriza e shkaktuar nga Serbia, zgjidhja ende shumë e largët! Kështu po! Të jam i qartë, reagimin nuk e bëra vetëm për shkrimin e DW-së, por pse kjo po bëhet politikë zyrtare e disa vendeve të BE-së.

12 vjet nga 10 shkurti



Shkruan: Albin KURTI

Më 2 shkurt 2007 u bë publike Paketa e Propozimit gjithëpërfshirës të Martti Ahtisaarit për statusin e Kosovës. Paketë e madhe gjithësepi sepse shumë padrejtësi ishin futur brenda. Shumica e dyfishtë në Kuvend, sundimi ndërkombëtar mbi Qeverinë, shuarja e TMK-së, decentralizmi etnik, eksterritorialiteti fetar, borxhi i jashtëm i Serbisë që na përshkruhej edhe neve. Këto i patëm quajtur gjashtë faqet e padrejtësisë së paketës kubike të Ahtisaarit, në të cilën askund s'figuronte fjala 'pavarësi', 37 herë përmendej fjala 'serb' dhe vetëm një herë ajo 'shqiptar', kur flitej për komunitetet joshqiptare! Protesta e 10 shkurtit 2007 kundërshtonte këtë padrejtësi shumëfaqëshe, shprehte vullnetin e popullit për liri dhe vetëvendosje, kërkonte sovranitet e pavarësi të plotë për Kosovën. Mijëra qytetarë u bashkuan në bulevardin "Nëna Terezë" në Prishtinë në marshin paqësor në ballë të të cilit

ishte Baca Adem (Demaçi) e i cili edhe mbajti fjalim. Por, drejt sheshit "Skënderbeu" na doli përballë policia e UNMIK-ut me tyta të gjata të pushkëve çifte. 232 plumba gome me afat të skaduar u shkrepën mbi kokat dhe gjokset e njerëzve paqësorë e të paarmatosur. U vranë Arben Xheladini dhe Mon Balaj, u plagosën rëndë me pasoja për tërë jetën Zenel Zeneli, Mustafë Nerjova e Hysni Hyseni, ndërkaq numri i të plagosurve që gjithsej kalonte 80, ishte pesëfish më i lartë sesa i atyre të arrestuar. Policët kishin ardhur për të qëlluar mbi neve, jo për të ruajtur ligjin e tyre.

Pas protestës së 10 shkurtit 2007, ndërmjetësi finlandez Ahtisaari ia dërgon Raportin e tij për Kosovën Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki-moon. Mirëpo, ia shton një faqe në fillim Propozimit të tij ku e përmend e thotë 'pavarësi' për Kosovën në kuadër të togfjalëshit 'pavarësi e mbikëqyruar'. Në po atë vit OKB-ja ndalon përdorimin e plumbave të gomës në misionet e saj nëpër botë, kurse një vit më vonë shpallet pavarësia e Kosovës.

Sikurse për Kosovën dhe humbjet e vuajtjet e saj të shumta, drejtësia ende mungon edhe për Monin e Arbenin dhe familjet e tyre. Kujtimi ynë për ta është i pashlyeshëm kurse lavdia e tyre e përjetshme.



Qeveria britanike kërkon më shumë kohë për marrëveshjen Brexitit

LONDËR, 10 SHKURT - Ndërsa afati për daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian është pas 47 ditësh, qeveria i kërkoi parlamentit të dielën që t'i japë më shumë kohë kryeministres Theresa May që ta ripunojë marrëveshjen për daljen.

Sekretari i Komuniteteve, James

Brokenshire, tha se parlamenti do ta kishte në dispozicion planin e May për Brexit, jo më vonë se më 27 shkurt. Premtimi është një përpjekje për të shmangur një debat të ashpër të enjten kur Parlamenti ka në program të debatohet dhe të votojë për hapat e mëposhëm në pro-

cesin e Brexit-it. Disa ligjvënës duan të përqipen të marrin kontrollin dhe të sigurojnë një dalje më të butë nga blloku.

Britania pritet të dalë nga Bashkimi Evropian më 29 mars, por parlamenti ka hedhur poshtë projektligjin e May për shkëputjen, duke detyruar

kryeministren të kërkojë ndryshime nga ana e BE-së.

Përpjekja e Britanisë për ndryshime të minutës së fundit, ka irrituar udhëheqësit e Bashkimit Evropian që këmbëngulin se marrëveshja e detyrueshme për tërheqje, nuk mund të ndryshohet.



Pasiguri për fatin e negociatave për shmangien e mbylljes së Qeverisë amerikane

Zyrtarë të lartë të Shtëpisë së Bardhë thonë se një mbyllje tjetër e qeverisë absolutisht nuk mund të përjashtohet dhe se presidenti Trump do të bëjë çfarëdo që të jetë e mundur ligjrisht për ta siguruar murin

WASHINGTON, 10 SHKURT - Kanë mbetur pak ditë nga afati kur presidenti Donald Trump dhe ligjvënësit duhet të arrijnë një kompromis për një marrëveshje për sigurinë e kufirit, e cila do të shmangte një tjetër mbyllje të qeverisë të premtën që vjen. Disa ligjvënës kishin thënë se ishin optimistë që mund të arrihej një marrëveshje, megjithëse mbetej e paqartë nëse presidenti Trump do ta pranonte atë.

Por, të dielën, senatori Richard Shelby, i cili kryeson grupin e republikanëve në negociatat për fondet për murin, tha se mendonte që bisedimet kanë ngecur dhe nuk ka besim se do ta arrijnë marrëveshjen.

Shefi i personelit në detyrë i Shtëpisë së Bardhë, Mick Mulvaney, tha se një mbyllje tjetër e qeverisë absolutisht nuk mund të përjashtohet. Mulvaney shtoi se presidenti Trump do të bëjë çfarëdo që të jetë e mundur ligjrisht për ta siguruar murin. Komisioni dypartiak pritej të paraqiste një propozim kompromisi këtë javë që vjen.

Aeroporte të bllokua, muze të mbyllura dhe punonjës të

papaguar të qeverisë... Këto janë disa nga skenat e mbylljes së qeverisë që mund të përsëriten nëse presidenti dhe Kongresi nuk arrijnë një marrëveshje për kërkesën e tij për murin kufitar. "Tani është momenti që Kongresi t'i tregojë botës se Amerika është e përkushtuar t'i japë fund emigracionit të paligjshëm dhe për t'i lënë pa punë hienat e paskrupullta, kartelet, trafikantët e drogës dhe të qenieve njerëzore", u shpreh presidenti Trump gjatë fjalimit për gjendjen e vendit.

Trumpi pranoi të miratojë një buxhet të përkohshëm të qeverisë për tre javë, deri më 15 shkurt, duke i dhënë kohë komisionit dypartiak të ligjvënësve për të gjetur një kompromis. Draft-marrëveshja duhet të miratohet gjithashtu nga Dhoma e Përfaqësuesve me shumicë demokrate, si dhe në vazhdim të dekretohet nga presidenti. "Nuk pres shumë nga ky komision pasi dëgjoj fjalë si 'do të japim çfarë do, por jo murin'. Problemi është se nëse nuk na japin murin, nuk do të funksionojë", deklaroi Trumpi.

Kryetarja e Dhomës së



Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, ka sinjalizuar se është e gatshme të mbështesë një buxhet për një lloj gardhi kufitar, për teknologjinë më të fundit dhe për më shumë personel në pikat e hyrjes kufitare. Por, demokratët qëndrojnë të bashkuar kundër buxhetit për një mur që dëshirohet nga mbështetësit e presidentit Trump. Ky ka qenë edhe një premtim i tij i përsëritur që nga ditët e para të fushatës për zgjedhjet presidenciale. "30% e bazës së tij qëndrojnë me të, por 70% e amerikanëve ende besojnë se emigracioni është

një gjë e mirë për vendin. Njerëzit nuk besojnë se duhet të kemi një mur në kufirin jugor", thotë ligjvënësja demokrate, Pramila Jayapal.

Presidenti Trump ndoshta do të pranojë një kompromis për të shmangur opsionin jopopullor të mbylljes së qeverisë, apo të shpalljes së emergjencës kombëtare në kufi për të siguruar buxhetin për murin. "Presidenti ka thënë gjithashtu se ka përgjegjësinë për sigurinë e amerikanëve dhe nuk mendoj se dikush vë në pikëpyetje autoritetin e tij ligjor për

të shpallur emergjencën kombëtare", u shpreh ligjvënësi Kevin McCarthy, udhëheqës i republikanëve në Dhomën e Përfaqësuesve.

Shumë republikanë nuk dëshirojnë që presidenti Trump të marrë këtë drejtim, pasi shpallja e emergjencës do të pasohet nga sfida të shumta ligjore ndaj autoritetit të presidentit. Sidoqoftë, ndërsa në horizont po afrohet gara presidenciale e vitit 2020, si demokratët ashtu edhe republikanët janë të ndërgjegjshëm për kostot politike të bërjes së lëshimeve për palën tjetër.

Protesta në Madrid kundër politikave të bisedimeve për Kataloninë



MADRID, 10 SHKURT - Mijëra protestues u mbledhën në Madrid të dielën për të kundërshtuar planin e Qeverisë spanjolle të uljes së tensioneve në rajonin e Katalonisë.

Partia Qendrore Djathtiste dhe Partia Qytetare, kanë thirrur protestën pasi kryeministri Pedro Sanchez u ofroi separatistëve një raportues për bisedime. Partia Djathtiste e ka konsideruar

këtë ofertë si tradhti dhe dorëzim. Separatistët kanë refuzuar ofertën. Edhe Socialistët e kundërshtojnë pavarësinë e Katalonisë. Grupet ekstreme djathtiste janë

po ashtu pjesë e protestës nën moton "Për Spanjën e bashkuar. Zgjedhje menjëherë". Autoritetet raportuan se numri total i demonstruesve arriti në 45 mijë.

Protestat në Serbi hyjnë në javën e dhjetë, kërkohet dorëheqja e Vuçiqit

BEOGRAD, 10 SHKURT - Mijëra njerëz kanë protestuar në Beograd dhe qytete të tjera të Serbisë të shtunën në mbrëmje, duke shënuar kështu dhjetë javë të presionit ndaj presidentit Aleksandar Vuçiq, me kërkesën për dorëheqje.

Protestat po zhvillohen nën moton #Inga5milionë, një thirrje që u vendos pasi Vuçiqi, vitin e kaluar kishte thënë për protestat e

qytetarëve se ai nuk do të tërhiqet edhe nëse dalin 5 milionë persona.

Protestës në kryeqytet iu bashkuan edhe studentët e Universitetit të Beogradit, të cilët bënë thirrje për dorëheqjen e ministrit të Arsimit, Mladen Sarçević.

Muajin e kaluar Sarçević ka përshkruar një grup të profesorëve universitarë që kanë përkratur

këtë lëvizje kundër presidentit si të "papeshtë". Protestuesit po e akuzojnë presidentin Vuçiq për shkelje të lirisë demokratike, kontroll ndaj medieve si dhe për goditjet ndaj kundërshtarëve politikë. Vuçiqi i ka mohuar këto akuza. Protestat u ndezën kur një grup njerëzish sulmuan me dhunë politikanin opozitar, Borko Stefanović në nëntor të vitit të kaluar.



LIGJI, PARAARDHËSIT DHE PASARDHËSIT



Flamur MALOKU

Kjo temë mund të shtrohet për debat në shumë veprimtari në Kosovë. Unë po e shtroj në timen: në fushën e kulturës, të respektimit të ligjeve të ndryshme në këtë fushë e të cilët, sidomos në dhjetëvjetëshin e fundit, edhe janë shtuar, edhe janë forcuar, edhe janë bërë më serioze sepse, duam apo s' duam, e pranojmë apo jo, pasardhësit kanë mësuar nga gabimet e paraardhësve dhe janë bërë më seriozë në punë, edhe po qe se u kërcënohet ndonjë rrezik në rrugë, lokal a vend pune nga kërcënuesit, s'e kanë fort shqetësim.

Një prej atyre që kanë mësuar nga gabimet e të tjerëve jam edhe unë. Pra, kam mësuar nga gabimet e paraardhësve, të cilët ose nuk kishin njohuri ose nuk kishin guxim të këmbëngulnin e të kërkonin respektim të ligjeve në fushën e kulturës. Kështu që, jam i bindur se unë dhe kolegët e mi kemi bërë

punë më të mirë se ta. Kështu si unë, pra punë të mirë për të tashmen dhe të ardhmen e librit dhe të gjithë kulturës shqipe dhe të huaj, kanë bërë edhe kolegët e mi, anëtarë të Këshillit të Librit të Ministrisë së Kulturës, pa dyshim ministri i Kulturës, zotëri Kujtim Gashi, Zyra Ligjore e kësaj ministrie, gjithë administrata e saj, edhe disa prej institucioneve varëse të saj si, ta zëmë, Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani", e cila, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Këshillin e Librit, i jep informacione Këshillit të Librit për botuesit që respektojnë Ligjin për bibliotekat dhe atë për Veprimtari botuese, pra për dorëzimin e ekzemplarëve të obligueshëm në Bibliotekë. Po ashtu, i jep informacione edhe për ata botues që nuk i respektojnë këto dy ligje, të cilët janë bërë me qëllim të zhvillimit të librit dhe të politikave të tij e të cilët, ne qe jemi zgjedhur anëtarë të Këshillit të Librit nga ministri Gashi dhe ata të tjerët që janë propozuar nga institucionet e kulturës, të arsimit dhe të shkencës në këtë Këshill Libri, duhet t'i respektojmë gjithqysh, me çfarëdo vaktie që mund të na ndodhë nga të pakënaqurit!

Po kush janë këtu paraardhësit, pasardhësit dhe kush është

ligji?!

Kuptohet, paraardhësit janë ata që ishin pas pasardhësve. Ata që para meje dhe para kolegëve të mi kanë qenë anëtarë të Këshillit të Librit, të ish-ministrave të Kulturës, të cilët, edhe pse e dinin se ekziston Ligji për bibliotekat dhe ai për Veprimtari botuese, edhe pse kishin edhe rregullore pune, nuk merrnin veprime për t'i detyruar keqpërdoruesit për respektim të ligjeve e të rregulloreve. Vazhdonin paraardhësit ta shkëlqenin Ligjin për bibliotekat dhe atë për Veprimtari botuese duke i përkrahur, me mijëra euro, disa prej botuesve që as sot, edhe pse u kërkohet me detyrim ligjor, nuk e respektojnë asnjërin prej dy ligjeve që zura në gojë më sipër. Ata që bënin këtë shkelje nuk ishin një a dy veta, po njëmbëdhjetë veta; një çerdhe intelektualësh; përfaqësues të institucioneve më të rëndësishme të kulturës, të arsimit dhe të shkencës. Po, jo njohës të ligjeve. Jo respektues të ligjeve. Jo njerëz me vullnet të mirë për t'i luftuar, me mish e me shpirt, dukuritë e këqija në kulturë.

Ndryshe prej paraardhësve, bërë punë shkel e shko dhe favorizuar shumë shkelësit e ligjeve, pasardhësit sot bëjnë tjetër punë: punojnë ndershëm

dhe nuk mbyllin sytë para keqpërdoruesve. Para asnjërit. As s'i bëjnë kujt dredhi, po as favor askujt. Zgjedhin vlerat më të mira, më të çmueshme. Ata që i plotësojnë kriteret publike të Ministrisë së Kulturës, për hartimin e të cilëve marrim pjesë edhe ne - anëtarët e Këshillit të Librit. Dhe meqë anëtarët e Këshillit të Librit janë përzgjedhur nga ministri dhe janë përfaqësuar nga institucionet dhe e kanë besimin e tij ashtu sikurse ai e ka në ne, dhe meqë të gjithë aty janë njerëz të dijeve të ndryshme dhe të arriturave të shumta letrare dhe shkencore, secili prej tyre sot kërkon, përpos vlera, edhe respektim të ligjeve dhe të kriterëve të konkursit të Ministrisë së Kulturës nga secili botues i ri dhe i vjetër.

Por, megjithatë, duket se disa botues nuk do të mësojnë të bëhen më të mirë sesa që janë sot, kurrë. Më mbushet mendja të them kështu kur shoh veprimtarinë botuese të disa prej tyre bërë që disa vjet, kryesisht në Kosovë, që prej themelimit të shtëpive të veta, të ashtuquajtura botuese, me të cilat kanë rrezikuar kujtesën e Kosovës dhe të ardhmen e librit, të cilën kujtesë dhe të cilët libra i kanë mbajtur larg mureve të "Pjetër Bogdanit" dhe larg ligjeve e sot nuk i kanë


kund botimet e para. Nuk e di a kanë qenë dhe a janë në dijeni për këtë dëm të madh dhe të pariparueshëm që ia kanë bërë librit dhe kulturës?! S'besoj se do të mbledhin mendtë as në të ardhmen sepse tradita e punës së tyre e keqe është shumë e gjatë dhe u duhen disa vjet kohë për të bërë punë të ndryshme e me rregull. Ata mund të mos ndryshojnë kurrë, po as ne s'kemi plan të ndryshojmë, përpos që të vazhdojmë ta respektojmë Ligjin për bibliotekat, për Veprimtari botuese dhe t'i shtojmë dhe shtrëngojmë kriteret për përfitim material për botim të librit në secilin konkurs për botim, për blerje dhe për përkrahje të librit e të revistave. Meqë e dimë rëndësinë e botimit të librit dhe kemi detyrë të kujdesemi për botimin e tij, do t'i kujdestarojmë edhe rastet e respektimit të Ligjit për bibliotekat dhe të atij për Veprimtari botuese edhe më tutje. Edhe me më këmbëngulje do ta bëjmë kulturën më të mirë dhe shtetin më të fortë. Mundësitë i kemi. Na ka ofruar ligji. Detyra. Besimi. Kontrata.

(Autori është anëtar i Këshillit të Librit i Ministrisë së Kulturës, i përzgjedhur nga ministri Kujtim Gashi. Pikëpamjet në këtë artikull janë personale)

REXHEP QOSJA: VEPRA DHE EMRI I KIÇO BLUSHIT MBESIN NË HISTORINË E KULTURËS SHQIPTARE

PRISHTINË, 10 SHKURT (ER) - Akademik Rexhep Qosja, pas ndarjes nga jeta të gazetarit, shkrimtarit dhe skenaristit të njohur Kiço Blushi, ka thënë se ai ushtroi ndikim çlirues, përparues, qytetërues, demokratizues në jetën e në krijimtarinë shpirtërore shqiptare. "Me pikëllim të madh mësova lajmin për ndarjen nga jeta të shkrimtarit, skenaristit, publicistit dhe veprimtarit të shquar kulturor Kiço Blushi. Të gjithë ata që e njohën, të gjithë ata që e takuan, siç pata fatin ta njoh e ta takoj edhe unë, nuk

do ta harrojnë kurrë. Me fjalën e tij gjithmonë të ndershme, gjithmonë të qartë e të vendosur, me përkushtimet e tij mendore e ndjenjore ndaj të drejtës e të vërtetës, ai ushtroi ndikim çlirues, përparues, qytetërues, demokratizues në jetën e në krijimtarinë shpirtërore shqiptare. Vepra e tij dhe emri i tij mbetin përgjithmonë në historinë e kulturës së popullit shqiptar. Familjarëve, miqve e dashamirëve të tij të shumtë u shpreh ngushëllimet e mia më të thella", ka shkruar Qosja në llogarinë e vet në "Facebook".



E jashtëzakonshme

Tenton të arratiset, i burgosuri bie nga tavani

Tentativa e një të burgosuri për t'u arratisur ka shkuar keq. Blaze Ayers po dërgohej në qeli në një burg në Qarkun Jackson në Indiana, kur u largua me vrap nga oficerët dhe u mbyll në një dhomë mjekësore. Në kohën kur policët hynë në dhomë, 28-vjeçari kishte hyrë në tavan dhe tentoi të largohej



nga aty por, përpjekjet e tij për t'u arratisur, dështuan pasi tavani ku po ecte u shemb dhe ai ra para tre policëve me armë.

BARSOLETA E DITËS



Një person kishte nevojë t'i nënshtrohej një operacioni. U mblodhën të gjithë mjekët dhe nisi operacioni. Pas disa orësh doli doktori nga salla e operacionit e tha: Operacioni shkoi me sukses, por pacienti vdiq.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



FOTO E DITES



Personeli Detar i Pakistanit marshon me flamujt e vendeve pjesëmarrëse në stërvitjen shumëkombëshe të marinës 'AMAN-19'. /AFP/

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



E rrallë

Pacienti vdes nga një sfungjer

Një pacient ka ndërruar jetë në Kaliforni pasi kirurgët i harruan një sfungjer në bark, njoftuan raportet nga Departamenti i Shëndetësisë. Pacienti, emri dhe gjinia e të cilit nuk është identifikuar, pati një ndërhyrje kirurgjikale për një enë gjaku që ishte bllokuar në fund të barkut. Nuk



konsiderohet si operacion i rrezikshëm, ndonëse është procedurë serioze, por për këtë pacient rezultoi fatale.



Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/KinoABC).



DASHI

Keni shumë gjëra


pozitive si tip, jeni të ndershëm dhe mjaft korrekt me ata që ju rrethojnë. Sot kjo gjë do të vlerësohet.



DEMI

Si fillim duhet ta krijoni terrenin e

përshtatshëm, pastaj të procedoni për t'i realizuar projektet tuaja ambicioze.



BINJAKËT

Kurioziteti është arma juaj kryesore sot

dhe është dhe një nga virtytet tuaja më të mira. Gjithmonë kërkoni informacion përpara se të veproni.



GAFORRJA

Miq të mund të kenë gjithmonë

besim tek ju se dini t'i ruani sekretet dhe jeni mjaft të rezervuar për t'i shprehur ndjenjat tuaja.



LUANI

Edhe pse dëshironi të dominoni dhe të jeni gjithmonë në rolin e liderit, sot do të dini të ofroni më shumë qetësi për një mbështetje morale.



VIJGJËRËSHA

Edhe pse në ditët që do të vijnë do të keni shumë ngarkesë në punë, do të dini se si ta përballoni më së miri.



PESHORJA

Mundohuni të jeni të kuptueshëm sot dhe mateni fjalët që thoni. Mund të lëndoni pa dashje dikë për të cilin keni shumë respekt.



AKREPI

Gjithmonë arrini të gjeni zgjidhjet shumë më përpara të tjerëve falë intuitës suaj të pagabueshme që ju ndihmon gjithmonë.



SHIGJETARI

Optimist dhe pozitiv gjithmonë e shikoni gotën gjysmë plot. Por, edhe te njerëzit përçoni të njëjtën ndjesi.



BRICJAPI

Nuk ju tremb aspak koha që duhet të impenjoheni për të zgjidhur një çështje të caktuar. Jeni mjaft i përqendruar në detaje.



UJORI

Mendoni se të tjerët përkushtohen ndaj jush në të njëjtën mënyrë si ju ndaj tyre. Sot do të pësoni një zhgënjim lidhur me një person.



PESHQIT

Shumë shpesh humbni në botën e ndjenjave, por kjo gjë ju bën shumë të ndikueshëm dhe mjaft të paqëndrueshëm.

Mariah Carey bashkë me fëmijët vizitojnë Disneylandin



Këngëtarja e famshme botërore, Mariah Carey, së fundi ka vizituar parkun Disneyland. Carey atje dërgoi dy


binjakët e saj për vizitë. Sipas fotografive të shpërndara në internet, ata shihen se janë shumë të lumtur.

Brad Pitti merr pjesë në ditëlindjen e ish-gruas



Epabesueshme, por Brad Pitti ishte pjesë e 50-vjetorit të lindjes së ish-gruas së vet, Jennifer Aniston. Aktroi 55-vjeçar është parë brenda festës të shtunën mbrëma në hotelin "Sunset Tower" në Los Angeles. Çifti

nisi lidhjen në vitin 1998, u martua në korrik të vitit 2000 dhe më pas njoftoi ndarjen në janar të vitit 2005. Shfaqja e tyre përfundimtare publike ishte në tetor të vitit 2004, ndërkaq divorci i tyre u finalizua në tetor të vitit 2005.



Mila Kunis dhe Zoe Saldana takohen rastësisht në një parking të veturave

Aktorja hollivudiane, Mila Kunis, është takuar rastësisht me miken e saj, Zoe Saldana. Ato u fotografuan nga paparacët

gjatë së shtunës teksa e përqafonin njëra-tjetrën kur u takuan. Ato të dyja u takuan në një parking të veturave në Los Anxhelos.

Zac Efron ndjek në "Instagram" Selena Gomezin



Aktori i famshëm Zac Efron ka filluar ta ndjekë në "Instagram" këngëtarën Selena Gomez. Sipas "Hollywood Life", fansat e Efron supozojnë se

ky mund të jetë një fillim i mbarë për të dy aktorët. Pasi mundën të nisin një lidhje dashurie, ata të dy do të dukeshin shumë të bukur si çift.

Një dokument i rëndësishëm për likuidimin e Mulla Idriz Gjilanit



Prof. dr. Sabile
KEÇMEZI-BASHA

Ditë më parë, gjatë muajit të manifestimit "Flaka e Janarit" 2019, në Gjilan, nën organizimin e Lidhjes së Historianëve, dega në Gjilan dhe nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, zotëri Lutfi Hazirit, u organizua një tryezë shkencore për jetën dhe veprën e Mulla Idriz Gjilanit me rastin e 70-vjetorit të likuidimit të tij.

Në këtë tryezë referova me temën "Nënë Hatixheja, grua trime e Mulla Idrizit" dhe, thënë të drejtën, kumtesa pati një jehonë të pranishmit dhe u komentua gjatë në komunitetin e pjesëmarrësve. Por, ajo që më brengosi më së shumti gjatë referimeve, në asnjë kumtesë nuk u përmend ndonjë datë e saktë e likuidimit të Mulla Idrizit. Të gjithë ne mbështeteshim në të dhënat që kishte lënë prof. dr. Muhamet Piraku e ndonjë tjetër. Thënë të drejtën, kam hulumtuar shumë për patriotin e devotshëm të Anamoravës, por nuk kam hasur në ndonjë të dhënë, veç datave të diskutueshme, siç ishin 26 nëntori, 29 nëntori apo ndonjë datë tjetër. Dilema kishte vazhdimisht dhe hulumtuesit e shumtë e thoshin hapur.

Por, në tryezën shkencore, në fjalët përshëndetëse, u paraqit edhe djali i Mulla Idrizit, Isa Hajrullahu dhe, mes të tjerash, ai përmendi datën e likuidimit të babait të tij apo respektivisht të Mulla Idriz Gjilanit, 2 dhjetorin e vitit 1949. Nuk dija a e hetoi dikush tjetër, por mua më alarmoi kjo datë ngaqë askush deri më tani nuk e kishte përmendur këtë datë.

Pas përfundimit të tubimit, me familjaret e Mulla Idrizit bëmë shumë fotografi dhe në bisedë e sipër e pyeta se çfarë ishte kjo datë e re e likuidimit të atdhetarit. Biseduam gjatë me zotëri Isan dhe ai me plot dashamirësi më ofroi një dokument që deri në atë moment nuk e kisha parë. Gjatë dorëzimit të dokumentit, ai pati të vetmen kërkesë që të shkruaja diçka për të. I premtova se për këtë arsye po e merrja për ta publikuar.

Paraprakisht, para se të shkruaja për dokumentin, e ndiej për obligim të them disa fjalë për figurën e ndritshme të hoxhës atdhetar Mulla Idriz Gjilanit. Mulla Idriz Gjilani veprimtarinë e bujshme atdhetare e kishte filluar që nga fëmijëria dhe e kishte

vazhduar deri në fund të jetës. Çka është e vërteta, atdhetari jetoj shkurt, por në këtë hark kohor veproi bujshëm e me guxim duke e tmerruar armikun shekullor. Dhe lirshëm mund të thuhet se m'u kjo ndikoi që ta tërhiqte vëmendjen e pushtetarëve e spiunëve, ndaj ndjekjet e vazhdueshme të okupuesit u bënë një me të, derisa edhe e zbuluan dhe arrestuan. Pushtetarët e ndienin dhe e nuhasnin rrezikun nga veprimtaria e Mulla Idrizit. E ajo frikë nga ai ishte e madhe... shumë e madhe... Kosova pas riokupimit më 1945, ishte fuçi baroti, së cilës i mungonte vetëm një fije shkrepe për ta ndezur Ballkanin. Prandaj, ishte krejt e natyrshme që ata shtuan represaliet e dhunën ndaj shqiptarëve vetëm për ta zbuluar se ku fshihej patrioti Mulla Idrizi.

Nga shumë dokumente të kon-

të kohës dhe në mënyrë ciklike vjen dhe na i kujton ngjarjet e shumta nga një kohë jo shumë e largët, kur kujtimet janë të freskëta dhe në momente lufta e madhe i tij të bëhet më e rëndësishme se çdo gjë tjetër në jetët tona.

E pikërisht, për këtë luftë që zhvilloi, ai u detyrua të qëndronte pesë vjet në sarkofagun me madhësi 80X397X220 cm, pa u takuar me askënd dhe pa e ditur as familjarët e ngushtë të tij. Pa dashur të imponohet se fati i këtij atdhetari duket sikur vjen thellë nga kohët, por me një ndryshim të vockël, se jeta e tij ishte trinom me guximin, lirinë dhe vuajtjen. Dhe, nevoja e një ristudimi të jetës së tij, siç është edhe ky dokument, i cili për një kohë të gjatë ka qenë i pazbuluar, të imponohet të mendosh se sa frikë ka pasur pushteti nga ai. Pushtetarët bënin gjithçka vetëm

tjerë.

Dhe pa hezituat, mund të thuhet se të gjithë këta me vetëdije të lartë atdhetare ua falën jetën idealeve të larta kombëtare dhe asgjë nuk kërkuan si shpërblim, veçse realizimin e ëndrrës së madhe të atdhetarëve për ta parë Kosovën të pavarur e të lirë, nga i cili gjakim nuk mund ta shkulin askurrë tekta e historisë.

Por, ndiej për obligim që gjithsesi të përmendi, se Mulla Idrizi, pas vdekjeve të dy bashkëshorteve te para, ai u martua për herën e tretë me Hatixhe Rexhepin nga Gjilani, me të cilën pati tre fëmijë: vajzën Eminen, dhe dy djem: Musanë dhe Isanë. Gruaja e Mulla Idrizit jo që ishte bashkëshorte e devotshme e tij, por ishte edhe shoqe e idealeve, që e përkrahu pa rezervë në të gjitha ndeshtrashat e jetës. Ose thënë më ndryshe, jo vetëm që e përkrahu, por në momente të caktuara diti edhe ta nxiste, duke i dhënë kurajë për rrugën e filluar. Për këtë dëshmon edhe e dhëna që edhe pas shumë mundimeve e peripecive që kishte pësua nga udbashët, ajo kurrë nuk foli dhe nuk tregoi se ku ndodhej burri i saj. Përkrahja e saj kishte një domethënie të madhe për luftëtarin, se edhe në momente të rënda të jetës i jepte zemër për qëndruesë dhe për ditët që vinin.

Shtrohet pyetja: Kush ishte Mulla Idriz Gjilani?

Mulla Idriz Velekinca lindi në Velekincë, të Gjilanit, më 4 qershor të vitit 1901. Mësimet fillestare i ndoqi në mejtepin e Černicës të Gjilanit (1911), shkollën e mesme e mbaroi në medresenë "Atik" në Gjilan, ku dhe diplomoi më 1926. Në moshën 25 vjeçare bëhet imam dhe merr titullin "Mulla". Shërbeu si Imamit në Karadak e në Hogosht të Dardanës. Më 1941 u zgjodh në postin e bashkëligjëruesit të Kuvendit fetar-arsimor të Vakëfit të Shkupit. Në edukimin e tij si fetar e atdhetar, ai u nis nga ky parim se ne shqiptaret: "Kemi tri fe, por kemi vetëm një Atdhe... një gjak, një gjuhë një diell e një Zot.... Detyrë mbi detyra kemi bashkimin dhe mbrojtjen e Atdheut..." dhe shtonte "Pa një atdhe të lirë feja



sultuara më ka rastisur të shihja se për organet e pushtetit ishte shumë e rëndësishme të arrestonin dhe të dënonin ata që kishin ndikim në masa dhe gëzonin respektin e tyre. Veç kësaj, atdhetari i madh Mulla Idrizi, me punën e vet dhe ndikimin e pakontestueshëm në masa, ka herë kishte tërhequr vëmendjen, se ora e fundit po trokiste për lirinë e Kosovës. Shekuj luftimesh bënë shqiptarët e shumë të vetëm pse gjakoni lirinë. Një fat të tillë e pati edhe Mulla Idriz Gjilani, i cili në veprimtarinë e vet na shfaqet e na rishfaqet në një pamje shumëdimensionale: si hoxhë, si vizionar, si realist, si atdhetar i devotshëm i çështjes kombëtare, si diplomat e përfaqësues politik i shqiptarëve në shumë tubime kombëtare e ndërkombëtare, si njeri i patjetërsueshëm dhe si luftëtar i madh i lirisë, që një ditë, jo të largët, gjakonte për ta bërë e për të parë Kosovën në gjirin e shtetit amë.


Duke shkruar, hulumtuar dhe analizuar jetën e veprën e Mulla Idrizit, vizioni i tij, në të shumtën e rasteve, na del jashtë kornizave

e vetëm që të falsifikonin vdekjen e tij prej trimi. Andaj edhe shpiknin lloj-lloj marifetesh pa u ndalur e menduar se të gjitha ato që thoshin ata binin në kundërshtim me vet jetën dhe veprën e Mulla Idrizit. Përveç faktit që mbushet një zbrazëti e ndjeshme deri më tash, hapen edhe shtigje të reja për t'u parë më me plotni veprimtaria atdhetare e Mulla Idrizit dhe atdhetarëve të tjerë, bashkëlufëtëtar të heroit, sepse Mulla Idrizi ishte dhe mbeti një figurë e madhe, e dashur, me një natyrë kryengritëse, guximtar deri në vetësakrificë. Në të njëjtën kohë ishte popullor, me një aktivitet e kontribut të spikatur në dobi të çështjes kombëtare.

Atdhetari Mulla Idriz Gjilani ishte i vetëdijshëm se çfarë i përgatitej dhe se çka e priste nga organet e OZN-ës, se edhe më herët, por edhe më vonë, në këtë mënyrë e kishin pësuar shumë atdhetarë nga ana e "Pushtetit të ri popullor". Një fat të tillë e kishte pasur edhe Prof. Ymer Berisha, Gjon Serreqi, Marije Shllaku, Halim Orana, Myderriz Haki Efendi - Sermaxhaj, e shumë atdhetar të

nuk mund të mbahet kurrë, nuk mund të ushtrohet. Lexoni veprat e të diturve dhe të urtëve sa e mirë, për t'u bindur sa e kuptueshme është feja islame, kur shpjegohet shqip, në gjuhën e Zotit për shqiptarët".

Gjatë kohës si hoxhë zhvilloi një veprimtari intensive në fushën e edukimit fetar me frymë atdhetare. Hapi mejtepin e Pidiçit për mësimin e djemve dhe të vajzave, organizoi ilegalisht mësimin e shkrim-leximit me alfabetin e gjuhës shqipe, futi mësimin shqip në medresenë "Atik", ushqeu mirëkuptimin dhe bashkëpunimin vëllazëror me bazë kombëtare shqiptare në popullsinë myslimane-katolike të zonës së Karadaku. Në prill të vitit 1937, në ilegalitet të thellë, themeloi në Arllat të Drenicës Organizatën e Rinisë Përparimtare "Drita" të Kosovës. Aktivitetet e tij fetare nuk dalloheshin nga ato atdhetare e humane. Mulla Idrizi ishte kundër shpërnguljes së shqiptarëve. Mulla Idrizi printe në aksionet për ndërtimin e urave, rrugëve, krojeve, mejtepeve, xhamive, mirëmbajtjes së varrezave, të cilat i shikonte si mjete dëshmuese të bashkimit të popullsisë shqiptare. Uniforma e ndihmoi për të maskuar aktivitetin e tij patriotik. Në kohën kur Mulla Idriz Gjilani ushtronte detyrën e ligjëruesit numri i nxënësve të "Atik medresesë" të Gjilanit arriti në 734, nga të cilët 326 ishin femra. Po ashtu i organizoi shkollat lëvizëse me mësues shëtitës. Vetëm në zonën e Gjilanit u hapën 39 shkolla të tilla fetare, që zgjuan te brezi i ri ndjenjat fetare dhe ndërgjegjen kombëtare. Nga prilli 1941 Mulla Idrizi iu kushtua plotësisht veprimtarisë politike. Ai luftoi për unitetin territorial të trevave shqiptare, luftoi kundër gjencidit serb e bullgar, kundër komunizmit. Në qershor të 1944-s drejtoi betejën e Kikës, ku doli fitimtar. Veprimtaria e Mulla Idriz Gjilanit është heroike. E tillë është edhe periudha 1944-1949 dhe kallja e tij në zjarr më 2 dhjetor 1949. Mulla Idrizi njihej edhe si intelektual që fliste disa gjuhë të huaja dhe gjatë asaj periudhe kishte botuar disa punime fetare-shkencore. (Vijon)



Si evoluojnë organizmat? Ja eksperimenti që zgjat 500 vjet!

Është testi më i gjatë në histori dhe do të përfundojë më 30 qershor 2014. Shërben për të kuptuar kufijtë e jetëgjatësisë dhe si mund të zhvillohen dy lloje të baktereve në distancë kohore. Më 30 qershor 2014, dikush do të hapë për herë të fundit kutinë e lashtë të ruajtur të Universitetit të Edinburgut. Ekstrakoni tubat e mbetura, me delikatesën që meriton gjetjet arkeologjike. Pastaj do të kryhen testet e parashikuara në udhëzimet e bashkangjitura, të shkruara në një gjuhë të vjetër nga shkencëtarët që kanë jetuar pesë shekuj më parë.

Në atë moment, nëse gjithçka shkon mirë, mund të thuhet se ka përfunduar eksperimenti më i gjatë në botë. Dhe pasardhësit e nipërve tonë do të kenë pjesët përfundimtare që të përpiqen t'i përgjigjen një pyetjeje fatale: sa mund të jetojnë, dhe si do të vdesin, nga mikroorganizmat e vërejtura për bukurinë e gjysmës së mijëvjeçarit?

500 vjet

Po flasim për eksperimentin 500-vjeçar, një studim i filluar në vitin 2014 me urdhër të dy astrobiologëve, britanikut Charles Cockell dhe gjermanit Ralf Moeller. Përqendrimi në kufijtë e jetëgjatësisë së organizmave të gjallë është thelbësore për ata që janë të interesuar të kuptojnë origjinën, evolucionin dhe shpërndarjen e jetës në univers. Në këtë rast u përzgjod-



hën format e fjetura të *Bacillus subtilis* dhe *Chroococciopsis*. I pari është një bakter i tokës, i aftë për të mbijetuar në kushte ekstreme në formën e spores. Kush e di, ndoshta edhe në një anije kozmike të akuzuar për transportimin e jetës në planete të largëta. I dyti është një mikrob fotosintetik, i cili mbijeton në shkretëtirë, duke hyrë në një gjendje vegetative.

Në shishe të mbyllura

Tani ata janë të dy brenda shisheve të dehidratuara dhe të

vulosura, të destinuara për t'u rihapur dhe studiuar në intervale të rregullta nga shkencëtarët e së ardhmes së afërt dhe të largët. Duke rihidratuar përmbajtjen dhe duke vëzhguar kolonitë bakteriale, deri tani nuk ka pika vitaliteti, sipas kontrollit të parë të botuar në revistën *Plos One*. Aventura sapo ka filluar, sigurisht, por disa kërkime mbi sporet e zgjuara më parë erdhën mirë. Ne flasim për bakteret e gjetura në kanaçe të mishit dhe u sollën përsëri në jetë pas 118 vjetësh. Dikush

madje pretendon se ka ringjallur sporet e ruajtura në kristalet e kripës të formuara para shfaqjes së dinosaurëve.

Mutacionet dhe dinamika

Nëse do të ishte e vërtetë, mikroorganizmat tona do të kishin një shans të mirë për të qenë gjallë në 500 vjet. Dhe të dhënat e mbledhura do të shërbejnë për të dokumentuar dinamikën e jetëgjatësisë: si ndryshojnë stoqet me kalimin e kohës? Cilat janë mutacionet kyçe që mund të përdoren për

të inxhinieruar mikroorganizmat? Në fund, megjithatë, ka të ngjarë që eksperimenti të jetë më interesant për historianët dhe për sociologët sesa për biologët dhe astronomët.

Kontrollet periodike

Për tremujorin e parë të shekullit kontrollet do të kryhen çdo dy vjet, atëherë frekuenca do të reduktohet, me intervale prej 25 vjetësh. A do të detyrohen shkencëtarët të kalojnë shkopin, duke përsëritur këtë ritual çdo çerek shekulli? Si do të punojnë universitetet në gjysmën e mijëvjeçarit? Nuk ka dyshim se shkopi USB i përdorur nga Cockell dhe Moeller për t'i lënë udhëzimet tek brezat do të bëhet së shpejti i padobishëm, në cilat lloje të mbështetjes në hap me kohën do të ngarkohen gradualisht informacionin?

Për të kuptuar sasinë e panjohur, mjafton të kthehemi me mendimin e 500 viteve: shtypja e luajtshme e Gutenberg ishte ende një shpikje e re, shkenca moderne nuk lindi, Magellani ende nuk e kishte qarkulluar globin. Asnjë futurist nuk mund të parashikojë fatin e qytetërimit njerëzor pas një hapi të barabartë përpara. Por, të paktën kemi një garanci, sepse eksperimenti ka një rezervë: një grup identik shishesh mbahen në Londër, në Muzeun e Historisë Natyrore. / *Gazeta Shqip*

Si ti kërkojmë falje një gruaje?

Keni bërë një gabim dhe mendoni se ajo nuk do tua falë. Sigurisht që këtu nuk futet tradhtia, për të do tu duhet të japim leksione të tjera. Por po flasim për gabimet e përditshme të jetës në çift që janë të pashmangshme. Të gjithë zemërohem me njëri tjetrin, pasi nuk ishim në darkë në orarin e duhur, apo nuk kishim bërë të gjitha detyrat për të cilat kishim rënë dakort.

Dashuria është një lëksion që mësohet çdo ditë, mos e harroni këtë. Nëse hiqni dorë nga përmirësimi i kësaj dëshire, atëherë rutina do ta bëjë të mërzitshme lidhjen tuaj. Por si ta fitoni sërish zemrën e një gruaje pasi e keni mërzitur atë? Mos harroni gratë pëlqejnë burrat që kanë ambicie personale, dhe për flasin për planet e tyre. Po ashtu ato pëlqejnë tu tregoni vazhdimisht që vazhdoni ti dashuroni. Nëse nuk ua

bëni të qartë këtë, ato do mendojnë se ju jeni duke u larguar nga to.

E ka miliona forma për ta shprehur dashurinë, ku më e thjeshta është një puthje e një përqafim. Por zemra e një gruaje është po aq e ndjeshme nga një lule, kështu një tufë me lulet që asaj i pëlqejnë apo qoftë një karafil i kuq, do të ndryshonte marrëdhënien tuaj. Mos hiqni dorë nga disa zakone të vogla që do ta bëjnë më të mirë raportin tuaj.

Një ftesë për darkë në fundjavë do të ishte ideale për të kërkuar ndjesë. Nuk është e nevojshme të flisni shumë. Nëse e ftoni të darkoni në restorantin që ajo pëlqen, ajo nuk do të ketë kohë për tu thelluar në zemërim, pasi do të mendojë se çfarë do të veshë.

Vishuni bukur. Një burrë sharmant arrin ta mposhtë zemërimin e një gruaje. Nëse



vishni një këmishë të re ajo do të tërhiqet nga pamja juaj dhe do të kërkojë arsyet e kësaj veshjeje. Një grua nuk mund të rrijë e qetë nëse burri që do

është në formë të mirë dhe i zemëruar me të. Në këtë rast është ajo që do të gjejë të gjitha mënyrat për tu afruar me ju. Mos harroni dashuria është një

lojë dhe fiton ai që di të luajë më mirë. Por përpuni ta shfrytëzoni këtë lojë për të përsosur jetën tuaj në çift dhe jo për ta zemëruar njëri tjetrin.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

WOLVES - NEWCASTLE UNITED

GG3+

HAMBURGER - DRESDEN

1

ALAVES - LEVANTE

1

Kupa sjell befasi, eliminohen Prishtina dhe Drita



Ndeshjet çerekfinale në garën e Kupës kanë qenë të jashtëzakonshme, kurse nuk kanë munguar edhe befasitë, pasi janë eliminuar kampionia aktuale, Drita dhe fituesja e Kupës në edicionin e kaluar, Prishtina

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINE, 10 SHKURT - Prishtina dhe Drita janë eliminuar nga gara e Kupës në futboll, kurse gjysmëfinalen e kanë siguruar Trepça '89 dhe Vëllaznimi. Të dielën gjysmëfinalen e siguroi edhe Ballkani, që e mposhti Kikën, derisa të njëjtën gjë e bëri edhe Feronikeli të shtunën që doli triumfues ndaj Ferizajt. Trepça '89 tejkaloi parashikimet pasi, pavarësisht prej faktit se nuk ishte llogaritur si kundërshtar i fortë për Prishtinën, arriti që të eliminojë këtë skuadër nga gara e Kupës. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" nuk solli gola në kohën e rregullt e as në

vazhdime, kurse fituesi u vendos në penallti. 89-shi doli skuadër më e sigurt nga pika e bardhë duke fituar me rezultat 5-4. Befasi bëri edhe Vëllaznimi nga Liga e Parë që e mposhti skuadrën e Dritës me rezultat 1-0 dhe në këtë mënyrë e eliminoi nga Kupa. Kuqezinjtë e Gjakovës në këtë mënyrë e përsëritën suksesin e vitit të kaluar kur në këtë fazë të garave e kishin mposhtur skuadrën nga Gjilani. Vëllaznimi realizoi golin e vetëm tre minuta pa përfunduar pjesa e parë nëpërmjet Tun Bardhokut, i cili realizoi një gol të bukur nga një largësi prej 15 metrash. Drita u mundua maksimalisht për ta barazuar rezultatit, por rastet e krijuara nuk i konkretizoi në gol. Drita është edhe jashtë garës për titull të kampiones,

derisa përforcimet e bëra duket se nuk do t'i hyjnë edhe aq shumë në punë. Të dielën kualifikimin në gjysmëfinale të Kupës e siguroi edhe Ballkani, pasi shënoi fitore në vazhdime ndaj Kikës me rezultat 1-0. Golin e fitores për skuadrën nga Suhareka e shënoi Edi Maksutaj në minutën e 115-të. Të shtunën në gjysmëfinale është kualifikuar Feronikeli që me golin e Kastriot Rexhës e mposhti Ferizajn (0-1). Në minutën e 20 Përparim Islami asistoi bukur deri te Rexha, i cili nuk gaboi dhe shënoi gol që doli të jetë vendimtar në kualifikimin tutje në garën për Kupë. Duhet cekur se "Nikli" pati edhe raste të tjera, por portieri Armend Blakqori nuk lejoi që Ferizaj të pranojë më shumë gola.

City e bëri 'horë' Chelsean

MANCHESTER, 10 SHKURT - Kampionia aktuale e Premierë Ligës, Manchester City, e ka bërë "horë" skuadrën e Chelseat, pasi e ka mposhtur

me rezultat 6-0. Skuadra e drejtuar nga Pep Guardiola ishte më e mirë që nga fillimi e deri në fund të ndeshjes, kurse skuadra e Chelseat e regjistron

paraqitjen më të dobët në këtë edicion garash. Tre gola në këtë ndeshje i shënoi Sergio Aguero, dy tjerë Raheem Sterling dhe një Ilkay Gundogan. Të dielën

fitore në Premierë Ligë ka shënuar edhe skuadra e Tottenham Hotspurit, pasi e ka mposhtur Leicester Cityn me rezultat 3-1.



SHKURT

Albulena Gërvalla fiton medaljen e bronzë në Evropian

Edhe një medalje evropiane e fituar nga karateja në kampionatin evropian që po mbahet në Aalborg të Danimarkës, për grupmoshat U-21, juniorë dhe kadetë. Këtë herë Albulena Gërvalla ka fituar medaljen e bronzë për U-21, kategoria deri në 55 kilogramë. Deri te medalja e bronzë karateistja jonë erdhi përmes repesazhit, ku shënoi tri fitore, ndërsa një tjetër e kishte arritur në luftën e parë. Dy ditë më parë edhe Melos Gashi, në grupmoshën e kadetëve, fitoi medaljen e argjendtë. Përfaqësuesja e karatesë po paraqitet në evropian me 25 garues.

Ramadani, i bronzë në Kampionatin Ballkanik

Talenti i atletikës, Muhamet Ramadani, e ka fituar medaljen e bronzë në Kampionatin Ballkanik U-20 me dyer të mbyllura (Indoor), i cili po mbahet në Stamboll. 16-vjeçari fitoi të bronzën në hedhjen e gjyles 6 kg. Rezultati i tij ishte, 17.35 metra.

Rashica shënon dy gola

Reprezentuesi i Kosovës, Milot Rashica, ka shkëlqyer të dielën në ndeshjen që Werder Bremini e fitoi ndaj Augusburgut me rezultat 4-0. Mesfushori shqiptar ka realizuar dy gola në këtë ndeshje, kurse paraqitja e tij ka qenë më e mira për skuadrën vendëse. Dy golat e tjetër për Bremenin i realizuan Johannes Eggestein dhe Kevin Mohwald.

UEFA dënon Mavrajn

Mërgim Mavraj pati një episod në takimin e humbur 4-0 ndaj Skocisë, ku goditi me kokë kundërshtarin Rajan Kristi dhe u largua me të kuq që në pjesën e parë. Megjithatë, ky gjest i ka kushtuar rëndë kapitenit të përfaqësues sonë. UEFA e ka dënuar atë me tri ndeshje pezullim. Lajmi është konfirmuar nga trajneri Christian Panucci, pasi më parë nuk është bërë publike. "Vendosi të kthehet në Gjermani dhe unë e shoh që aktivizohet, por për të nuk duhet të mendojmë tani, është i shkualifikuar për tri ndeshje. I uroj që të jetë mirë dhe ta mbaj formën, për të ardhmen të shohim", ishin fjalët e Panuccit.

Sot garojnë Klea Vrella dhe Elba Kokaj

PRISHTINË, 10 SHKURT - Skitaret e Kosovës, Klea Vrella dhe Elba Kokaj, kanë zhvilluar të dielën përgatitje për garën që zhvillohet sot (e hënë) në disiplinën slallom të Festivalit Olimpik Evropian Dimëror "Sarajeva & Sarajeva

Lindore 2019". Bashkë me trajnerët e tyre, Feim Kollçaku dhe Egzon Agani, skitaret janë përgatitur në shtegun olimpik të slallomit në Qendrën Skitare të Jahorinës. "Kushtet ishin mjaft të mira. Përgatitjet i

bëmë edhe në bashkëpunim me ekipet e tjera të Sllovenisë, Estonisë dhe Turqisë. Vajzat janë gati për slallomin e nesërm dhe shpresoj të kemi prezantim të mirë", ka deklaruar Kollçaku.

Gara e sotme në slallom fillon në orën 10:30 me lëshimin e parë, kurse lëshimi i dytë nis në orën 12:30. Vrella dhe Kokaj garojnë në disiplinën slallom dhe slallom të madh. Gara e slallomit të madh zhvillohet të mërkurën.



Distria e argjendtë, Akili i pesti në Paris

PRISHTINË, 10 SHKURT - Një medalje e argjendtë dhe një vend i pestë është bilanci i suksesit të xhudistëve të Kosovës në Grand Slamin e Parisit. Medaljen e argjendtë e fitoi Distria Krasniqi në kategorinë deri në 48 kilogramë, ndërsa vendin e pestë e zuri Akil Gjakova në kategorinë deri në 73 kilogramë.

Kampionia e Evropës, Nora Gjakova, u ndal në luftën e parë nga Jisu Kim e Koresë së Jugut, kategoria deri në 57 kilogramë. Kjo treshe përfaqësoi ekipin e xhudos në Paris. Në një konkurrencë të fortë, Distria, pas katër fitoreve, arriti në finale, ku humbi nga japonezja Ami Kondo. Ndërkohë, Akili, që vitin e kaluar fitoi të artën në këtë Grand Slam, këtë herë udhëtimi i suksesshëm u ndal pas tri fitoreve, konkretisht në gjysmëfinale dhe në luftën për të



bronzit, ku u mposht nga medalisti i artë olimpik nga Rio 2016, Fabio Basile. Krasniqi fitoi 700 pikë olimpikë për Tokio 2020, ndërsa Akili 360

sosh. Gara e Grand Slamit të Parisit vlerësohet ndër më të fortat në xhudo, kurse luftërat e së shtunës u ndoqën nga rreth 15 mijë të pranishëm.

Toronto triumfon ndaj New Yorkit

TORONTO, 10 SHKURT - Toronto Raptors marshon, pasi ka mundur këtë herë edhe New York Knicksin me rezultatin e ngushtë 99-104. Kyle Lowry ishte shënuesi më i mirë, me 22 pikë të realizuara. Ndryshe nga Raptorsi, është mposhtur këtë herë Milwaukee Bucks. Orlando Magicu i ka mundur 83-103, duke shfrytëzuar mungesën e Giannis Antetokounmpo. Houston Rockets-Oklahoma City Thunder ishte një takim mjaft interesant, që përfundoi me shifrat 112-117. Një ndeshje ku kishim edhe një duel Paul George-James Harden, që fitoi nga i pari. Plot 45 pikë të



shënuara, ndërkohë që edhe rikuperoi 11 topa. Harden nga ana tjetër shënoi 42 pikë. Paraqitje e mirë edhe për Russell Westbrookun, që regjistroi "triple-double": 21 pikë, 11 asiste dhe 12 topa të rikuperuar. Fitore e rëndësishme për Los Angeles Clippersin, që kaloi me

sukses Boston Celticsin me rezultatin 112-123. Kemba Walker, me 37 pikët e tij, udhëhoqi Charlotte Hornets në triumfin 120-129 kundër Atlanta Hawksit. Marvin Williamsi dhe Jeremy Lambi bënë gjithashtu një paraqitje shumë të mirë, pasi realizuan respektivisht 27 dhe 24

SHKURT

Buffoni: Nuk ka favorit në ndeshjen United - PSG

Gianluigi Buffoni beson se nuk ka favorit në duelin e Ligës së Kampionëve në mes të Paris Saint-Germainit dhe Manchester Unitedit, por i bëri thirrje skuadrës së tij të bëjë paraqitje më të fortë dhe më muskulore ndaj gjigantit të Premierligës. "Mendoj se duhet ta përmirësojmë mentalitetin, qëndrimin dhe shpirtin për të flijuar për ekipin. Të martën na pret një ndeshje shumë e rëndësishme. Duhet të bëjmë ndeshje të madhe. Ndeshja jonë ndaj Manchester Unitedit duhet të jetë më muskulore, më e fortë dhe me qëndrim ndryshe. Jo [nuk jemi favoritë], mendoj se është 50/50", ka thënë Buffoni.

Legjenda e pistave me ski mbyll karrierën me një medalje bronzi

Skiatorja amerikane Lindsey Vonn me garën e zbritjes së lirë të zhvilluar sot në pistën e Are, në Suedi, ka mbyllur zyrtarisht karrierën e saj sportive. 34-vjeçarja, fituese e 82 garave të Kupës së Botës, si asnjë femër tjetër, ka zhvilluar sot në Botërorin që po zhvillohet në Suedi garën e saj të fundit. Një lamtumirë për t'u mbajtur mend, pasi Vonn arrin ta fitojë medaljen e bronzit dhe ta mbyllë karrierën me një rezultat të rëndësishëm për të. "Në këtë garë dhashë maksimumin tim. Garova me zemër. Shpresoja të ngjitesha në podium dhe ia dola mbanë. Ndiheha si një 20-vjeçare kur nisa garën. Garat me ski kanë qenë miku im më i mirë në të gjithë jetën time", ka thënë Vonn. Ai që i dorëzoi medaljen dhe një buqetë me lule ishte legjenda e skive, Ingemar Stenmark, që me 86 fitore në Kupën e Botës është i vetmi skiator që ka fituar më shumë se Vonn. "Ai ka qenë pikë referimi për mua dhe e ftova të ishte pranë meje sot. E falënderoj që pranoi ftesën", ka deklaruar Vonn.

Sot zyrtarizohet transferimi i Hamsikit në Kinë

Marek Hamsik është kthyer në kryefjalë dite në Itali, teksa përpara disa ditësh pritej që të bëhet zyrtarizimi i tij si lojtari më i ri i ekipit të Dailan Jifang. Gjithsesi, transferimi dështoi, pasi ekipi kinez ndryshoi ofertën në momentet e fundit dhe Napoli ndaloi negociatat për marrëveshjen e sllovakut. Tashmë nga mediet italiane raportohet se klubet kanë gjetur përsëri gjuhën e përbashkët dhe Hamsik do të nis drejt Kinës. Njoftohet se prezantimi i mesfushorit pritet të bëhet ditën e sotme, sipas asaj që thuhet nga prestigjiozja "Corriere dello Sport". Dailan do të kalojë në arkat e Napolit plot 20 milionë euro, me lojtarin që do të përfitojë rreth 9 milionë euro në sezon.

PSG-ja në alarm, lëndohet edhe Cavani

Sikur të mos mjaftonte dëmtimi i yllit brazilian Neymar, te PSG-ja tani i duhet të bëjnë llogaritë pa një tjetër lojtar kyç. Bëhet fjalë për sulmuesin uruguian Edinson Cavani, i cili u pa duke çaluar gjatë ndeshjes ndaj Bordsosë, ku u zëvendësua menjëherë sapo mbaroi pjesa e parë. Në rast se 31-vjeçari nuk ia del të rikuperohet në kohë për takimin e ditës së martë ndaj Manchester Unitedit, trajneri i PSG-së, Tomas Tuchel, s'do të ketë zgjidhje tjetër përveçse t'ia besojë rolin e sulmuesit qendror talentit francez Kilyan Mbappe. Në mungesë të Neymarit dhe Cavanit, treshja e sulmit të PSG-së do të plotësohet nga Angel Di Maria dhe gjermani Julian Draxler. Ndërkohë, te "djajtë e kuq" dëmtimet janë shumë të pakta, pasi të vetmit lojtarë të padisponueshëm për Ole Gunar Solskjaer do të jenë mbrojtësit Darmian dhe Valencia.

REZULTATET

Utah J. - San Antonio S.	125-105
Indiana P. - Cleveland C.	105-90
Atlanta H. - Charlotte H.	120-129
New York K. - Toronto R.	99-104
Boston C. - Los Angeles C.	112-123
Chicago B. - Washington W.	125-134
Memphis G. - New Orleans P.	99-90
Houston R. - Oklahoma City Th.	112-117
Milwaukee B. - Orlando M.	83-103



		Autor: GAZMEND MORINA	AKTORJA AMERIKANE NË FOTO (shqip.)	SPECIALIST PËR VERË (SI PIJE)	TULLUMBACE (sh.shq.)	ELIZABETH TAYLOR	KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE	EPOKA E RE	KËNGËTARI ANGLEZ WEBBE	ZANORE	SËPATË E VOGËL (shq.)	VINÇ	ISH TRAJNERI YNË I BOKSIT LAH
			SHKAK (turq.)					ELEMENT KIMIK BASHKË, TOK					
			DEGË E MJEKËSISË							LETRARI ASLLANI PARAARDHËS I ITALIANËVE			
			DETYRË E AKTORIT NJËSI E MATJES SË NXEHTËSISË			SHASTISEM KALORËS MESJETAR							
								KRYEQYTETI I KANADASË SHYTYTJE, NXITJE					
			AKTORI I FAMSHËM DEPP (shqip.)				SULFUR, NATRIUM I PËRZJEVA				NYJE SHTET FEDERAL NË SHBA (shqip.)		
			E BËJ GATI						LËNGU I SYRIT LËNDË KRISTALORE SHUMË E ËMBËL				
			SENEGALI		DISIPLINË SPORTIVE SUPER MODELJA KANADEZE KATE ...					HAITI, OSAKA TEDI ALVES			SHALQI
EPOKA E RE	MBATHËSE SPORTIVE	DIÇKA QË ËSHTË JASHTË RREGULLIT TË CAKTUAR	MËNYRË E SHQIPTIMIT ME HUNDË TË TINGUJVE (ling.)	IVAN DACOUR	SHTET NË AFRIKË (pashq.)	ISMET MUNISHI		BAKËRPU-NUESI BASHKËT.					
TMERR I MADH						GRUP KËNGËTARËSH TITAN			KËNGËTARJA VIOLETË TITULL I SULLTANIT NË PERANDORINË OSMANE				BASHKËT. FUTBOLLISTI NASRI (shq.)
BREGDETAS								PJESË PËLHURË E THYER NË DYSH BASHKËT.			HEROI ... KUKA SHKENCËTARI SKËNDER		
TROPICAL ORCHESTRA ZONE				DJALË I VAJZËS KËNGËTARI BERISHA			IRONIA E HIDHUR KËNGËTARI ASLLANI				ALEN NURI SHUMË I LODHUR, I KËPUTUR		
SIMBOL I FESË MYSLIMANE, BESIM (shq.)						ANITA BITRI BASHKËT.		MBIZOTËRIMI					
FORTESË					NUMËR THEMELOR SHUFRA METALIKE TË LIDHURA SI SKELET (shq.)			ISMET SYLEJMANI ESTONIA, NORVEGJIA		POLITIKANI DOKLE			
AKTORJA AMERIKANE MILANO (shqip.)						REPER I YNI MC				PERËNDESHË E DASHURISË (mit. romake) EMBLEMA			UNITED STATES
EPOKA E RE	I THAJ PËRKUFIZIM					ELEKTRON, TON, NATRIUM ISH FUTBOLLISTI KROATI TUDOR			BASHKËT. TEATËR NË PRISHTINË		LETRARI ALI E FILLOVA		
BASHKËT.		KËNGËTARJA BABALIU FALJA FETARE DITORE QË BËJNË MYSLIMANËT						BUJTINË E MADHE MODERNE (shq.) TRUP QIELLOR					SIENA EMËR YNI FEMRE
INSTITUCION				FILLIM I AGIMIT SULMI		DY BASHKËTINGËLLORE SHKRONJA XVIII							I AFROJ (bised.)
NOTË MUZIKORE			GRIMCË MOLEKULARE ISMET TOTO					BASHKËT. ELANI, VRULLI		PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE SHPEND UJI SHTEGTAR			NEVOJË E MADHE PËR TË NGRËNË BASHKIM QELIZASH (sh.pashq.)
AXHAMI						HEALTH ALERT NETWORK ISH PORTIER OLIVER ...				SHTET I LASHTË NË AZI ROBERT IRVING AND BURNS			
MENDJEHOLLË						KËNGËTARJA GJERMANE SARA (shqip.) NOTË MUZIKORE				ALESANDRO NESTA TANTAL		ANNA VISI "OSASUNA"	
"IZMIR"		LLOJ MINERALI SHKRONJA XV									LIRIDONI (perkdh.) BASHKËT.		
SHOKU					PADITËS I SOKRATIT			APARTAMENT (sh.shq.)					



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense
Departamenti i Personelit/ Odsek Za Personal/Department For Personnel

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe nenin 12 të Rregullores Nr.02/2013 për Rekrutimin në FSK, Ministria e Mbrojtjes shpall:

KONKURS

Për rekrutimin e rekrutëve të rinj të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Grada:	Rekrut/OR-1
Statusi:	Aktiv
Vendi:	FSK

Kriteret e përgjithshme për rekrut/OR1 të FSK-së janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë të përfunduar shkollën e mesme;
- Të jetë i moshës 18-23 vjeç;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore e fizike për vendin e shërbimit;
- Të mos jetë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë.

Procedurat e shqyrtimit, filtrimit dhe përzgjedhjes:

- Shqyrtimi fillestar i aplikacioneve;
- Testi i aftësive;
- Testi fizik;
- Intervista me shkrim dhe me gojë;
- Testi mjekësor;
- Trajnimi;
- Verifikimi;
- Emërimi;
- E drejta e ankesës.

Dokumentet e kërkuara për aplikim:

- Diploma (dëshmi) e shkollimeve të mesëm të përfunduar;
- Dëshmi, certifikata, mirënjohje (nëse posedon);
- Certifikatën e lindjes (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Certifikatën e shtetësisë;
- Vërtetimin nga gjykata që nuk është nën hetime apo i ndjekur penalisht (origjinali);
- Kopje të letërnjoftimit apo pasaportës;
- Dy fotografi të formatit (5 cm x 5 cm).

Shënim:

Shtetasit e Republikës së Kosovës mund të pranohen në Forcën e Sigurisë së Kosovës pasi të kenë plotësuar kërkesat dhe kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes. Pranimi bazohet në gjendjen shëndetësore dhe fizike dhe sipas nevojave e prioriteteve të FSK-së dhe pas përfundimit me sukses të procedurës së miratuar për rastet në të cilat kërkohet verifikimi i kontrollit të sigurisë, respektivisht pastërtisë së figurës, sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe akteve të brendshme nënligjore të ministrisë. Pranimi në FSK konfirmohet pas përfundimit të trajnimit bazik, gjatë së cilës kohë, kandidatët do të cilësohen si rekrutë (OR1). Pas përfundimit të trajnimit bazik, rekrutët marrin gradën e ushtarit.

Si të aplikoni:

Formularët për aplikim janë në dispozicion në të gjitha kazermet e FSK-së, apo në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes, www.mksf-rks.org, apo www.rks-gov.net/mfsk ku gjendet konkursi i shpallur. Formularët duhet të dorëzohen personalisht, në të gjitha kazermet e FSK-së, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Kandidatët duhet t'ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të nevojshme. Dokumentet e pranuar nuk kthehen. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr.tel. 038-603-199, 038-603-355.

Afati i konkurimit:

Konkursi është i hapur prej **11.02.2019** deri më **22.02.2019**.

Ministria e Mbrojtjes iu shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet e femrave dhe meshkujve për shërbim në FSK, pa dallim nga përkatësia e tyre etnike.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense
Departamenti i Personelit/ Odelenje za Osoblje/Department for Personnel

Shodno çlanu 145, tačka 2, Ustava Republike Kosova, na osnovu člana 5 Zakona br. 06/L-122 o Ministarstvu Odbrane Republike Kosova, član 6 Zakona br. 06/L-124 o Službi u Kosovskim Bezbednosnim Snagama, kao i član 12 Pravilnika br. 02/2013 o Rekrutovanju u KBS, Ministarstvo Odbrane najavljuje:

KONKURS

Za regrutovanje novih regruta Kosovskih Bezbednosnih Snaga

Çin:	Regrut/OR-1
Status:	Aktiv
Mesto:	KBS

Opšti kriterijumi za KBS OR1/regrute su:

- Biti državljanin Republike Kosova;
- Imati završenu srednju školu;
- Starosti od 18-23 godina;
- Da poseduje punu sposobnost da deluje;
- Da poseduje neophodne zdravstvene i fizičke uslove za mesto službe;
- Da nije osuđen za krivično delo, pravosnažnom odlukom.

Procedure pregleda, filtriranja, i selekcije:

- Početni pregled aplikacija;
- Test sposobnosti;
- Fizički Test;
- Usmeni i pismeni intervju;
- Medicinski Test;
- Obuka;
- Bezbednosna Provera;
- Imenovanje;
- Pravo na žalbu.

Potrebne dokumente za prijavu :

- Diploma (dokaz) o završenom srednjom obrazovanju;
- Dokaz, sertifikate, zahvalnice (ako ih poseduje);
- Izvod rođenih (ne stariji od 6 meseci);
- Uverenje o državljanstvu;
- Provera od strane suda da nije pod istragom ili krivično gonjen (original);
- Kopije lične karte ili pasoša ;
- Dve slike formata (5cm x 5cm).

Napomena:

Građani Republike Kosovo mogu biti primljeni u Kosovske Bezbednosne Snage nakon ispunjavanja opštih kriterijuma i kriterijuma za selekciju. Prijem se zasniva na zdravstvenom i fizičkom stanju i u skladu sa potrebama i prioritetima KBS-a i nakon uspešnog okončanja odobrene procedure za slučajeve u kojima je potrebna provera bezbednosne kontrole, odnosno čistoće figure, u skladu sa relevantnim zakonima na snazi i unutrašnjim aktima ministarstva.

Prijem u KBS-u se potvrđuje nakon završetka osnovne obuke, tokom kojeg će se kandidati kvalifikovati kao regruti (OR1). Nakon završene osnovne obuke, regruti dobijaju čin vojnika.

Kako se prijaviti:

Formulari za prijavu dostupni su u svim kasarnama KBS-a, ili na web stranici Ministarstva Odbrane, www.mksf-rks.org ili www.rks-gov.net/mfsk gde je najava konkursa dostupna. Formulari moraju biti dostavljeni lično, u svim kasarnama KBS-a, svakog radnog dana od 09:00 do 15:00 časova do isteka roka konkursa. Kandidati moraju da prilože kopije dokumenata koji dokazuju ispunjenje neophodnih uslova. Prihvaćeni dokumenti se ne vraćaju. Za dodatne informacije možete nas kontaktirati na tel. 038-603-199, 038-603-355.

Rok konkurisanja;

Konkurs je otvoren od **11.02.2019** do **22.02.2019**.

Ministarstvo Odbrane služi svim građanima Republike Kosovo i pozdravlja aplikacije žena i muškaraca za službu u KBS-u, bez obzira na njihovu etničku pripadnost.

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"



**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333**

**American
Taste**

**SINCE
1905**



Me 10.02.2019 u bë një vit që u nda nga jeta
më i dashuri ynë:

SHABAN R. SERMAXHAJ

05.01.1969 - 10.02.2018

U bë 1 vit pa ty, nuk ka fjalë, lot as vajë që e shuan mallin për ty vëlla! Vdekja të ndau nga jeta, por jo nga zemrat tona! Ishe dhe do të mbetesh i dashur për të gjithë ne.

Sot të kujtojmë me mall dhe ngushëllojmë njëra - tjetrën se një ditë do të takohemi në amshim.

Të përkujtojmë: nëna Hata, motrat :Fatimja, Fatmirja, Habibja, Lumnija, Luljeta dhe Qamilja.



Ftohen të gjithë të interesuarit që për nevojat e Institutit Pedagogjik të Kosovës, të paraqesin ofertat e tyre për objekt me hapësira të përshtatshme për zyra me qira në Prishtinë, me sipërfaqe minimum 300 m², në largësi nga qendra (hotel Grandi) 1000 m. Objekti duhet të jetë i rrethuar me grila ose ndonjë rrethojë me material të fortë. Ofertuesit së bashku me oferta duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin shtesë:

- Fletën poseduese
- Kopjen e planit të objektit
- Lejen e ndërtimit të objektit
- Çmimi në euro për m²

Informatat e nevojshme mund ti merrni në zyrat e Institutit Pedagogjik të Kosovës, adresa Kompleksi ish-Rilindja, kontejneri nr.2, Prishtinë.

Për më shumë informata mund të kontaktoni në numrin e telefonit: **03820020352**.

Ofertat në zarf të mbyllur dorëzohen në adresën e mësipërme nga data 11.02.2019 deri më 20.02.2019, prej orës 8:00-16:00, me shënimin: **"Objekt me qira – Prishtinë"**.

Ofertat e dorëzuara pas këtij afati nuk do të shqyrtohen.

Prishtinë, 11.02.2019

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Reshat Vehapi shpall te pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Qerim Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Leke Dukagjini" Prizren.

► Xhemil Shehaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Bajram Curri" Prizren.

► Besnik Rexhbeqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Zenun Çoçaj" Gjonaj.

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m² me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m² për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.]

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales